



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

INPO
Iniciativa për progres

Praktikat e Prokurimit Publik: Nga Buxhetimi deri tek Menaxhimi i Kontratave



Rastet nga komunat: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec,
Vushtrri, Gjiilan, Deçan, Junik dhe Hani i Elezit

Tetor, 2021

Praktikat e Prokurimit Publik: Nga Buxhetimi deri tek Menaxhimi i Kontratave



Rastet nga komunat: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec,
Vushtrri, Gjiilan, Deçan, Junik dhe Hani i Elezit

Autor: Gzim Shala

Monitorues: Arbenita Topalli, Arrita Rezniki, Qëndrim Arifi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është përgatitur nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO) me mbështetjen e USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse.

Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Metodologjia	7
3. Aktivitetet Kryesore të Projektit	10
4. Buxhetimi me pjesëmarrje: Baza ligjore	11
5. Pjesëmarrja dhe përfshirja e qytetarëve në buxhetimin komunal.....	13
5.1. Sfidat dhe rruga drejt rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e buxhetit	18
6. Planifikimi, Menaxhimi i kontratave dhe prokurimi në komuna.....	20
6.1. Komuna e Prishtinës.....	21
6.2. Komuna e Gjakovës.....	25
6.3. Komuna e Pejës	28
6.4. Komuna e Rahovecit.....	30
6.5. Komuna e Vushtrrisë.....	33
6.6. Komuna e Gjilanit	35
6.7. Komuna e Deçanit	38
6.8. Komuna e Junikut.....	40
6.9. Komuna e Hanit të Elezit.....	44
7. Konkluzione	47
8. Rekomandime	49

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit “Kërkesa për Komuna Transparente dhe Llogaridhënese: Monitorimi i prokurimit publik dhe fuqizimi i qytetarëve për të sjellë ndryshime pozitive”, që implementohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO). Projekti ka pasur për qëllim monitorimin e proceseve të prokurimit publik në nëntë komuna: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri, Gjiilan, Deçan, Junik, dhe Hani i Elezit. Ky proces i monitorimit është realizuar për 4 faza të ndryshme të prokurimit publik: 1. Planifikimi i buxhetit komunal; 2. Planifikimi i prokurimit; 3. Proces i prokurimit, dhe 4. Menaxhimi i kontratave. Proces i monitorimit është realizuar përmes monitoruesve të cilët paraprakisht janë trajnuar për secilin proces. Ky proces i monitorimit është realizuar gjatë periudhës gusht 2020-prill 2021. Këta monitorues, gjatë procesit të monitorimit kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët përgjegjës komunalë. Për më tepër, disa nga aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, për të rritur kështu pjesëmarrjen e këtyre të fundit në vendimmarrje dhe në monitorimin e proceseve të prokurimit publik.

Për secilën nga 4 fazat e monitorimit, janë hartuar raporte specifike dhe të detajuara. Më saktësisht, janë hartuar tri raporte:

1. Planifikimi i Buxhetit Komunal për Vitin 2021: Raport mbi planifikimin e procesit të buxhetit në komunat: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri, Gjiilan, Deçan, Junik dhe Hani i Elezit;

2. Monitorimi i Procesit të Planifikimit të Prokurimit në Komunat: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri, Gjiilan, Deçan, Junik dhe Hani i Elezit; dhe

3. Analizë e procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave: Analizë nga monitorimi i aktiviteteve në komunat: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri, Gjiilan, Deçan, Junik, dhe Hani i Elezit.

Të gjitha raportet e cekura më lart, para publikimit, janë dërguar për komente tek zyrtarët përgjegjës komunalë. Në rastet kur hartuesit e raportit janë pajtuar me komente, të njëjtat janë integruar në raport, ndërsa në të kundërtën është krijuar një aneks i veçantë ku janë përfshirë të gjitha komentet e paadresuara së bashku me sqarimet për mosadresimin e të njëjtave.

Ndërsa, ky raport është një përmbledhje e gjetjeve kryesore nga tri raportet paraprake, dhe lexuesit inkurajohen që për detaje lidhur me gjetjet e paraqitura në këtë raport, t’u referohen tri raporteve të përmendura më herët, të cilat janë publikuar në: <https://kli-ks.org> dhe <http://inpo-ks.org>.

Sa i përket procesit të buxhetimit, IKD dhe INPO gjatë monitorimit kanë gjetur se konsultimi me shkrim dhe ai elektronik, si një ndër format obligative të konsultimeve publike, është pothuajse e pazbatuar nga komunat me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe Buxhetit Komunal. Sa i përket dëgjimeve buxhetore, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, katër (4) prej tyre kanë organizuar nga një takim publik gjatë draftimit të

Kornizës Afatmesme Buxhetore, derisa këtë obligim nuk e kanë përmbushur pesë (5) komunat tjera. Ndërsa, sa i përket dëgjimeve buxhetore me rastin e hartimit të buxhetit nga ekzekutivi i komunës, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, katër (4) prej tyre nuk kanë organizuar dëgjime buxhetore, derisa dëgjime buxhetore kanë organizuar pesë (5) komunat tjera. Disa prej këtyre komunave dëgjimet buxhetore i kanë mbajtur në mënyrë virtuale, për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19. Sa i përket dëgjimeve buxhetore, sfida e përbashkët e të gjitha komunave është pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në këto dëgjime, veçanërisht e grave.

Lidhur me planifikimin e prokurimit, gjetjet e IKD-së dhe INPO-së, dëshmojnë se asnjëra nga komunat e monitoruara nuk e kanë të njëjtë vlerën e aktiviteteve të planifikuara me kapacitetet buxhetore që komuna ka në dispozicion për ato aktivitete. Përderisa Komuna e Vushtrrisë ka më shumë buxhet sesa vlera totale e aktiviteteve për punë të planifikuara, komunat e tjera kanë planifikuar projekte për punë pa pasur buxhet për zbatimin e tyre, përkatësisht kanë në dispozicion më pak buxhet sesa ai që kanë planifikuar me plan të prokurimit.

Gjatë monitorimit të procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë gjetur se komuna e Deçanit, Gjakovës, Prishtinës dhe Junikut kanë kërkuar kërkesa teknike dhe profesionale në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Tutje, përveç kësaj IKD dhe INPO kanë vërejtur dukurinë e shkurtimeve të afateve për pranimin e tenderëve. Nga monitorimi i këtyre aktiviteteve, IKD dhe INPO gjejnë se në pesë (5) raste, në katër komuna të ndryshme janë aplikuar afate të përsheptuara. Nga arsyet e cekura nga ana e komunave të identifikuara që kanë shkurtuar afatet, mund të përfundojmë se asnjëri shkurtime nuk është konform kërkesave ligjore dhe se këto shkurtime fare nuk kanë të bëjnë me situata urgjente.

Sa i përket menaxhimit të kontratave, gjetjet e monitorimit konsistojnë në atë se: Komuna e Deçanit dhe MKRS si donator i këtij projekti nuk kanë arritur që konform kushteve të kontratës dhe nivelit të punëve të kryera t'i ekzekutojnë pagesat tek Operatorët Ekonomikë. Si rrjedhojë e hulumtimit të validitetit të sigurisë së ekzekutimit të kontratës, IKD dhe INPO gjejnë se Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Junikut nuk kanë arritur që t'i respektojnë dispozitat ligjore lidhur me këtë, përkatësisht kanë nënshkruar kontratë pa siguri të ekzekutimit valide dhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

2. Metodologjia

Ky projekt është zbatuar përmes një metodologjie specifike të hartuar për qëllimet e këtij projekti. Kjo metodologji, ka pasur si qëllim kryesor një proces transparent dhe të paanshëm të monitorimit. Për më tepër, përfshirja e qytetarëve në procesin e monitorimit, ka qenë një ndër specifikat më me rëndësi të kësaj metodologjie. Më poshtë, gjeni një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së monitorimit, për secilën fazë:

1. Planifikimi i Buxhetit

Procesi i planifikimit të buxhetit komunal është monitoruar përmes monitorimit të dëgjimeve publike, kërkesës për qasje në dokumente publike, dhe përmes analizës së buxhetit të miratuar. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, janë monitoruar vetëm ato seanca që janë mbajtur në formatin online. Ndërsa, seancat e realizuara në formë fizike, janë monitoruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike. Përveç buxhetit komunal për vitin 2021, projekti ka monitoruar edhe procesin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB).

Gjatë monitorimit të këtij procesi, projekti është fokusuar në:

1. Pajtueshmërinë e planifikimit të buxhetit me kërkesat ligjore;
2. Pjesëmarrjen e zyrtarëve kryesor komunalë (Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit Komunal) në dëgjime buxhetore;
3. Pjesëmarrjen e qytetarëve në këto dëgjime dhe përfaqësimin gjinor;
4. Dorëzimin e buxhetit komunal tek asambleja komunale në afatin e caktuar kohor;
5. Publikimin e draftit të buxhetit për rishikim, para aprovimit të tij;
6. Përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar.

2. Planifikimi i Prokurimit

Procesi i planifikimit të prokurimit është realizuar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe komunikimit dhe intervistave me zyrtarët e prokurimit dhe me departamentet e tjera të përfshira në këtë proces. Për të siguruar një proces transparent dhe të paanshëm të monitorimit, projekti ka përzgjedhur për monitorim *5 kontratat e para për furnizime*, për secilën komunë. Është monitoruar planifikimi i prokurimit për vitin 2020.

Gjatë monitorimit të këtij procesi, projekti është fokusuar në:

1. Përputhshmërinë e planit të prokurimit me buxhetin komunal;
2. Përputhshmërinë e planit të prokurimit me kërkesat ligjore;
3. Respektimin e afateve kohore lidhur me dorëzimin e planit të prokurimit tek Agjencia Qendrore e Prokurimit;
4. Për 5 kontratat e përzgjedhura, përputhshmërinë e sasive të planifikuara, njërive dhe vlerave të parashikuara me procesin e tenderimit;
5. Përputhshmërinë e kontratave me afat të gjatë (1-3 vite) me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve;
6. Nëse numri i projekteve kapitale në planin e prokurimit, është i njëjtë me atë në buxhetin komunal për të njëjtin vit;
7. Nëse komunat realizojnë hulumtim të tregut, dhe në çfarë forme e realizojnë atë.

3. Procesi i Prokurimit

Gjatë monitorimit të procesit të prokurimit, për secilën komunë, janë përzgjedhur nga dy tenderë, një i vlerës së madhe dhe një i vlerës së mesme, që janë përzgjedhur bazuar në:

- Vlerën;
- Numrin e ankesave;
- Sektorin e rrezikut;
- Procedurat e kufizuara;
- Rëndësinë e projektit për komunitetin.

Kontratat e përzgjedhura për monitorimin e procesit të prokurimit janë aktivitete të iniciuara gjatë viteve 2019-2020.

Monitorimi i këtij procesi është realizuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, dhe ky proces është monitoruar në tri faza:

1. Para procesit të tenderimit

- a. A është planifikuar projekti me buxhetin komunal?
- b. A është përfshirë në planin e prokurimit?
- c. A është bërë deklarata e disponueshmërisë së fondeve?
- d. A janë përcaktuar qartë kriteret dhe kushtet për vlerësimin e ofertave?

2. Gjatë procesit të tenderimit

- a. A ishin anëtarët e komisionit vlerësues të ofertave të kualifikuar për të shqyrtuar ofertat?
- b. A kishin këta anëtarë udhëzime të mjaftueshme nga zyra e prokurimit në lidhje me procedurat e prokurimit që duhen respektuar?
- c. A kishte ndonjë kërkesë për rishqyrtim në rastin e njoftimit të dhënies së kontratës?
- d. A kishte ndonjë kërkesë të tenderuesit për ndryshim ose modifikim të kriterëve të dosjes së tenderit?
- e. Komuna, në rast të gabimeve e ndryshoi apo modifikoi dosjen e tenderit?
- f. Sa operatorë ekonomikë janë deklaruar të përgjegjshëm?
- g. A është deklaruar ndonjë prej operatorëve më i lirë se fituesi i përgjegjshëm? Nëse po, pse dhe a kanë qenë arsyet bindëse?
- h. Nëse është zbatuar procedura e duhur e prokurimit?
- i. Analiza e specifikimeve teknike;
- j. Monitorimi dhe nxjerrja në pah e ankesave nga operatorët ekonomik që marrin pjesë në proces;
- k. Ndonjë devijim eventual nga afatet ligjore.

3. Pas njoftimit për dhënien e kontratës

- a. A ka pasur ndonjë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)?
- b. Çfarë ka vendosur OSHP-ja për ankesën?
- c. A e respektoi institucioni vendimin e dhënë nga OSHP-ja?

4. Menaxhimi i Kontratave

Menaxhimi i kontratave po ashtu është monitoruar përmes përzgjedhjes së dy kontratave për secilën komunë, një kontratë të vlerës së madhe dhe një kontratë kornizë. Kontratat janë përzgjedhur bazuar në:

- Vlerën;
- Numrin e ankesave;
- Sektorin e rrezikut;
- Procedurat e kufizuara;
- Rëndësinë e projektit për komunitetin.

Kontratat e përzgjedhura për këtë fazë të monitorimit janë aktivitete të iniciuara gjatë viteve 2018-2020.

Procesi i monitorimit është zhvilluar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe përfshirjes së qytetarëve në procesin e monitorimit. Në këtë drejtim, janë themeluar nëntë (9) trupa monitoruese si dhe janë intervistuar qytetarët e lagjeve të ndikuara nga projekti lidhur me implementimin e tij.

Monitorimi është zhvilluar me fokus në këto specifika:

- a) A është emëruar menaxheri i kontratës?
- b) A ka menaxheri kualifikimet dhe kohën e mjaftueshme për të mbikëqyrur zbatimin e kontratës?
- c) A ka ndonjë konflikt interesi për menaxherët e kontratave?
- d) A është hartuar plani i menaxhimit të kontratës?
- e) A ka mekanizma të tjerë përveç menaxherit të projektit që mbikëqyrin cilësinë e zbatimit të kontratës?
- f) A janë përmbushur kërkesat ligjore për menaxhimin e kontratës?
- g) A është përfunduar saktësisht aspekti teknik i menaxhimit të kontratës?
- h) A janë realizuar pagesat për operatorët ekonomik në kohë?
- i) A janë realizuar pagesat në përputhje me nivelin e përfundimit të kontratës?
- j) A janë zbatuar ndëshkimet eventuale në lidhje me kompanitë kontraktuese?
- k) A ka ndonjë aneks-kontratë të lidhur?
- l) A është përfunduar projekti në kohë?
- m) A ka përfunduar projekti siç është planifikuar dhe a i përmbush objektivat e propozuara?

3. Aktivitetet Kryesore të Projektit

Projekti “Kërkesa për Komuna Transparente dhe Llogaridhënëse: Monitorimi i prokurimit publik dhe fuqizimi i qytetarëve për të sjellë ndryshime pozitive”, përveç monitorimit të proceseve të prokurimit të cekura më lart, ka pasur si qëllim edhe rritjen e vetëdijes dhe përfshirjen e qytetarëve lidhur me proceset e prokurimit publik. Për më tepër, projekti ka

realizuar aktivitete në drejtim të përkrahjes së organeve komunale për realizimin e aktiviteteve të caktuara, si dhe në drejtim të rritjes së komunikimit mes organeve komunale, qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, dhe këshillave komunale.



4. Buxhetimi me pjesëmarrje: Baza ligjore

Procesit të hartimit të buxhetit komunal i paraprinë hartimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore. Sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2021, Ministria e Financave dhe Transfereve përmes qarkores së lëshuar më 15 maj 2020, ka obliguar Komunitat që të përgatisin dhe të aprovojnë këtë dokument deri më 30 qershor 2020.

Procesi i hartimit dhe miratimit të buxhetit komunal është i rregulluar me Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili Ligj ka po ashtu edhe pesë (5) plotësim-ndryshime. Sipas këtij Ligji, procedura e hartimit të buxhetit komunal për vitin e ardhshëm duhet të fillojë më së largu më 1 korrik të vitit paraprak. Pasi Kryetari i Komunës të miratojë propozim-buxhetin komunal, i njëjti obligohet që jo më larg se data 1 shtator e vitit përkatës, të dërgojë propozim-buxhetin komunal në Kuvendin Komunal. Ndërsa, Kuvendi Komunal i komunës përkatëse obligohet që të miratojë buxhetin për vitin e ardhshëm më së largu deri më 30 shtator të vitit paraprak, të cilin buxhet duhet ta procedojë në Ministri të Financave.

Korniza ligjore dhe nënligjore garanton të drejtën e qytetarëve për përfshirje në procesin e draftimit si të Kornizës Afatmesme Buxhetore, ashtu edhe të Buxhetit Komunal.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka miratuar Udhëzimin Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Sipas nenit 6 të këtij udhëzimi administrativ, *“1.Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:...1.3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme; 1.2. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor”*.

Neni 10 i këtij udhëzimi administrativ përcakton format dhe teknikat e konsultimit publik. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton gjithsej 13 forma dhe teknika të konsultimit publik, derisa paragrafi 32 i po të njëjtit nen nënvizon se *“Konsultimi me shkrim dhe elektronik, publikimi në ueb-faqen e komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime publike, si dhe së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara janë të obligueshme në procesin e konsultimit publik”*.

Sa i përket mbajtjes së konsultimeve publike, neni 13 i këtij udhëzimi administrativ përcakton se *“Para aprovimit të një projekt propozimi, organi propozues vendos për hapjen e procesit të konsultimit publik”*. Pas përfundimit të konsultimeve publike mbi Kornizën Afatmesme Buxhetore, respektivisht buxhetin komunal, ekzekutivi i komunës përkatëse obligohet që të publikojë një raport mbi rezultatet e procesit të konsultimeve publike. Në këtë drejtim, neni 5.5. i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna përcakton se *“Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara”*.

Sa i përket buxhetit komunal, pasi që Kryetari i Komunës përkatëse procedon në propozim-buxhetin për vitin përkatës në Kuvendin Komunal, edhe Kuvendi Komunal obligohet që të mbajë dëgjime publike me qytetarët, para se ta miratojë propozim-buxhetin komunal.

Obligimi i kuvendeve komunale për të mbajtur dëgjime buxhetore para miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm është e rregulluar me dispozita ligjore. Në këtë rast, Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se *“Pas pranimit të propozim-*

buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës”.

Sa i përket përfshirjes së qytetarëve në hartimin e politikave të komunave dhe transparencës së këtyre institucioneve, në fuqi është edhe Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, neni 6 i së cilës obligon komunat për transparencë financiare, derisa edhe Komunitet e Republikës së Kosovës kanë miratuar rregullore që i referohen dhe kanë për qëllim ngritjen e transparencës.

5. Pjesëmarrja dhe përfshirja e qytetarëve në buxhetimin komunal

Gjatë procesit të monitorimit, IKD dhe INPO kanë gjetur se të gjitha komunat kanë miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Buxhetin vjetor.

Sa i përket përfshirjes së qytetarëve në draftimin e këtyre dy (2) dokumenteve, standardet minimale të konsultimit publik lidhur me draftimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore ngërthejnë obligimin e komunës përkatëse për të zbatuar të paktën (3) lloje të formave të konsultimit publik:

1. Konsultimi me shkrim dhe elektronik;
2. Publikimi në faqen zyrtare të komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike;
3. Së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara.

Në këtë drejtim, lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Buxhetin vjetor, IKD dhe INPO kanë monitoruar zbatimin e këtyre obligimeve nga nëntë (9) komunat, të cilat si të ndara, janë të paraqitura në vijim.

Sa i përket konsultimit me shkrim dhe atij elektronik, si një prej formave obligative për konsultimet publike, IKD dhe INPO gjejnë se gjatë draftimit të KAB-it, këtë formë të konsultimeve publike nuk e kanë zhvilluar asnjë prej komunave të monitoruara. Ndërsa, lidhur me draftimin e buxhetit vjetor komunal, IKD gjen se këtë formë obligative të konsultimeve publike e ka zbatuar vetëm Komuna e Vushtrrisë, derisa nuk e ka zbatuar asnjë prej tetë (8) komunave të tjera të monitoruara.

Lidhur me obligimin për publikimin të njoftimit për konsultime publike dhe draft-KAB-in komunal, IKD dhe INPO kanë gjetur se as këtë obligim nuk e kanë përmbushur plotësisht asnjë prej komunave të monitoruara. Ky obligim ishte përmbushur pjesërisht vetëm nga Komuna e Pejës dhe ajo e Rahovecit. Përafërsisht nivel i tillë i mos zbatimit të kësaj forme obligative të konsultimeve publike qëndron edhe tek draftimi i buxhetit komunal. Nga të gjitha komunat e monitoruara, IKD dhe INPO gjejnë se vetëm Komuna e Hanit të Elezit ka përmbushur pjesërisht këtë obligim gjatë fazës së konsultimeve publike.

Gjatë fazës së draftimit të KAB-it, IKD dhe INPO gjejnë se katër (4) nga nëntë (9) komunat e monitoruara kanë zbatuar obligimin për mbajtjen e takimeve publike. Përkatesisht, këtë

obligim e kanë zbatuar Komuna e Pejës, Rahovecit, Junikut dhe Hanit të Elezit, të cilat gjatë draftimit të KAB-it, kanë mbajtur nga një (1) takim publik.

Ndërsa, lidhur me draftimin e buxhetit komunal, gjatë monitorimit IKD dhe INPO kanë gjetur se pesë (5) prej nëntë (9) komunave të monitoruara kanë mbajtur dëgjime buxhetore, derisa nuk kanë organizuar katër (4) komuna të tjera. Përkatësisht, dëgjime buxhetore gjatë draftimit të buxhetit komunal kanë organizuar Komuna e Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Rahovecit dhe Hanit të Elezit. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës dëgjimet buxhetore i kanë organizuar në mënyrë virtuale.

Sa i përket numrit të dëgjimeve publike gjatë fazës së draftimit të buxhetit vjetor, Komuna e Rahovecit ka organizuar gjithsej 15 dëgjime buxhetore, ajo e Pejës nëntë (9), Gjakovës gjashtë (6), Prishtinës pesë (5) dhe Hanit të Elezit një (1).

IKD dhe INPO gjatë procesit të monitorimit kanë monitoruar edhe nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto dëgjime buxhetore, i cili nivel, në parim, mbetet i ulët. Po ashtu, me këtë rast është monitoruar edhe përfaqësimi gjinor në këto dëgjime buxhetore.

Lidhur me dëgjimet buxhetore të organizuara me rastin e draftimit të KAB-it komunal, IKD dhe INPO gjejnë se dëgjimet buxhetore të katër (4) komunave që kanë organizuar këto dëgjime buxhetore, kanë marrë pjesë gjithsej 69 qytetarë, 58 prej të cilëve burra dhe 11 gra.




Tabela 1: Numri i pjesëmarrësve dhe përfaqësimi gjinor në takimet publike të organizuara gjatë draftimit të KAB-it.

Ndërsa, sa i përket dëgjimeve buxhetore të organizuara me rastin e draftimit të buxhetit komunal, IKD dhe INPO gjejnë se në të gjitha dëgjimet buxhetore të organizuara nga pesë (5) komunat e monitoruara, kanë marrë pjesë gjithsej 498 qytetarë, 428 prej të cilëve burra dhe 70 gra. Numri më i lartë i pjesëmarrësve është evidentuar në dëgjimet buxhetore të Komunës

së Pejës, derisa numri më i ulët është evidentuar në Komunën e Prishtinës, ku numri total i pjesëmarrësve në këto dëgjime buxhetore ka qenë më i ulët se sa vet numri i dëgjimeve buxhetore, pasi në disa dëgjime buxhetore, nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar.



Tabela 2: Përfaqësimi gjinor në dëgjimet buxhetore

IKD dhe INPO kanë monitoruar edhe zbatimin e obligimit të komunave për publikimin e raportit përfundimtar pas përfundimit të procesit të konsultimeve publike. Me këtë rast, IKD dhe INPO gjejnë se asnjë prej komunave të monitoruara nuk e kanë përmbushur plotësisht këtë obligim, as sa i përket KAB-it dhe as sa i përket buxhetit komunal. Sa i përket KAB-it, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, këtë obligim pjesërisht e ka përmbushur vetëm Komuna e Rahovecit, derisa sa i përket buxhetit komunal, këtë obligim vetëm pjesërisht e ka përmbushur Komuna e Gjakovës.

Sipas Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kryetari i Komunës obligohet që deri më 1 shtator të vitit përkatës, t'ia dorëzojë Kryesuesit të Kuvendit Komunal buxhetin e propozuar për vitin pasues. Por, ky afat nuk është zbatuar në asnjë prej komunave. Kjo për arsye se gjashtë (6) ditë para arritjes së këtij afati, përkatësisht më 26 gusht 2020, Ministria e Financave i është drejtuar të gjithë kryetarëve të komunave me kërkesë për të mos proceduar me Propozim-Buxhetin Komunal për vitin 2021. Kjo kërkesë arsyetohej me faktin se që nga fillimi i vitit 2020, vendi është përballur me pandeminë COVID-19 dhe si rezultat i kësaj, ka rënie të të hyrave buxhetore për vitin 2020. Sidoqoftë, me disa dallime të vogla, të gjitha komunat kanë arritur që gjatë muajit shtator ta procedojnë buxhetin në kuvendin komunal.

Sa i përket kuvendeve komunale, të gjitha kuvendet komunale të komunave të monitoruara kanë organizuar dëgjime buxhetore gjatë fazës së shqyrtimit të draft-buxhetit komunal. Nga nëntë (9) komunat e monitoruara, tetë (8) prej këtyre komunave, këto dëgjime buxhetore i kanë organizuar në bashkëpunim me IKD dhe INPO. Në kuadër të projektit, IKD dhe INPO

në bashkëpunim me kuvendet komunale kanë organizuar dëgjime buxhetore në të gjitha komunitat e monitoruara, përjashtimisht në Komunën e Hanit të Elezit, Kuvendi Komunal i së cilës komunë ka organizuar dëgjime buxhetore pa përkrahje të IKD dhe INPO. Për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19, IKD dhe INPO në bashkëpunim me komunitat e monitoruara, dëgjimet buxhetore i kanë organizuar në mënyrë virtuale, përmes platformës Zoom. Me qëllim të ngritjes së transparencës dhe përfshirjes maksimale të qytetarëve, të gjitha dëgjimet buxhetore të organizuara nga IKD dhe INPO, në bashkëpunim me komunitat përkatëse, janë transmetuar drejtpërdrejt në faqet zyrtare të IKD-së dhe INPO-së, në rrjetin social Facebook. Ndjekja e këtyre dëgjimeve buxhetore nga qytetarët përmes rrjetit social Facebook ka variuar nga 2,400 deri në 13,000 shikime. Ndërsa, të gjitha dëgjimet buxhetore së bashku, kanë arritur rreth 63,000 shikime.

Pas dëgjimeve buxhetore, të gjitha komunitat e monitoruara kanë arritur që brenda afatit ligjor ta miratojnë buxhetin vjetor, përjashtimisht Komunës së Prishtinës, e cila buxhetin vjetor e ka miratuar me 2 tetor 2020.

Po ashtu, të gjitha komunitat kanë publikuar buxhetin vjetor të miratuar, përjashtimisht Komunës së Junikut.

Gjatë procesit të monitorimit të procesit të buxhetimit, IKD dhe INPO kanë mbledhur të gjitha kërkesat buxhetore, dhe pas publikimit të draft-buxhetit komunal, kanë identifikuar nivelin e përfshirjes së kërkesave qytetare në buxhetin e miratuar.

Sa i përket draftimit të KAB-it, kërkesa të qytetarëve janë identifikuar vetëm në Komunën e Hanit të Elezit dhe Komunën e Junikut. Në Komunën e Hanit të Elezit janë identifikuar gjithsej 8 kërkesa të qytetarëve, një (1) prej të cilave është përfshirë në KAB-in e miratuar, dy (2) nuk janë përfshirë derisa në pesë (5) të tjera nuk ka mundur të identifikohet përfshirja në KAB-in komunal. Ndërsa, në Komunën e Junikut janë identifikuar katër (4) kërkesa të qytetarëve, një (1) prej të cilave është përfshirë, një (1) nuk është përfshirë dhe dy (2) të tjera nuk kanë mundur të identifikohen.

Lidhur me buxhetin komunal, në tabelën në vijim janë paraqitur të dhëna të detajuara lidhur me numrin e kërkesave të qytetarëve dhe përfshirjes së tyre në buxhetin komunal.

Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar					
Komuna	Nr. i kërkesave buxhetore	Të përfshira	Pjesërisht të përfshira	Të pa përfshira	Nuk mund të identifikohet
Hani i Elezit	26	3	0	10	13
Gjakovë	41	27	0	12	2

Rahovec	226	88	0	39	99
Gjilan	14	2	0	5	7
Vushtrri	263	3	0	55	205
Prishtinë	15	3	1	7	4
Pejë	213	3	0	93	117
Deçan	10	1	1	5	3
Junik	8	0	0	4	4

Tabela 3: Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar.

Në anën tjetër, IKD dhe INPO kanë analizuar edhe bilancin e projekteve komunale për qytetarë dhe administratë:

Bilanci i projekteve komunale për qytetarë/ për administratë			
Komuna	Projekte për qytetarë	Projekte për administratë	Përqindja e buxhetit të projekteve për qytetarë, në raport me buxhetin total për investime kapitale
Prishtinë	98 (28,082,837€)	6 (510,000€)	94.23%
Deçan	26 (2,356,703€)	1 (150,000€)	94.02%
Rahovec	80 (4,263,979€)	3 (23,000€)	99.46%
Gjakovë	84 (7,677,302€)	2 (125,000€)	98.40%
Hani i Elezit	24 (440,127€)	0	100%
Gjilan	26 (5,951,743€)	2 (315,000€)	94.97%

Pejë	37 (7,732,226€)	4 (265,000€)	96.69%
Vushtrri	55 (4,029,154€)	3 (30,000€)	99.26%
Junik	6 (79,305€)	1 (80,000€)	49.78%

Tabela 4: Bilanci i projekteve komunale për qytetarë/për administratë.

Ndërsa, në tabelën në vijim, IKD ka paraqitur të dhënat e projekteve të përfshira në buxhetet e miratuara, që pasqyrojnë bilancin në mes projekteve të reja dhe atyre në vazhdim:

Bilanci projekt i ri/ vazhdim i projekteve komunale			
Komuna	Projekt i ri	Vazhdim nga vitet paraprake	Përqindja e projekteve të reja
Prishtinë	58	46	55.77%
Pejë	8	34	19.05%
Gjakovë	41	45	47.67%
Gjilan	1	27	3.57%
Vushtrri	32	26	55.17%
Rahovec	16	67	19.28%
Deçan	11	16	40.74%
Junik	1	6	14.29%
Hani i Elezit	10	14	41.67%
Gjithsej	178	280	38.86%

Tabela 5: Bilanci projekt i ri/ vazhdim i projekteve komunale.

5.1. Sfidat dhe rruga drejt rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e buxhetit

Lidhur me dëgjimet publike si formë e konsultimit publik për hartimin e buxhetit, sipas të dhënave të paraqitura si më lart, si aspekt shumë sfidues evidentohet pjesëmarrja e ulët e

qytetarëve në këto dëgjime publike. Duket se informimi i pamjaftueshëm i publikut për të drejtën, mundësinë dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në fazën e buxhetimit është një prej arsyeve kryesore të pjesëmarrjes së ulët të qytetarëve në këto dëgjime buxhetore. Me këtë rast, IKD dhe INPO vlerësojnë se kjo pamjaftueshmëri e publikut për këtë proces, duhet të adresohet në mënyrë institucionale dhe strategjike, për të informuar publikun mbi të drejtën, rëndësinë dhe mundësinë për pjesëmarrje në buxhetim. Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në dëgjime të tilla publike e ulë efektin e kërkuar nga kjo formë e konsultimit publik, duke e shndërruar në një formë të konsultimit me karakter të përgjithshëm, në diskutim me një grup të vogël të qytetarëve.

Me këtë rast, krahas sfidave të tjerave, për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, disa prej komunave dëgjimet buxhetore i kanë mbajtur në mënyrë virtuale, i cili fakt, për shkak të vështirësive teknike për qasje, krahas të tjerave, ka ndikuar po ashtu në pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në këto dëgjime publike. Për më tepër, IKD dhe INPO gjatë monitorimit të procesit të buxhetimit në nëntë (9) komuna kanë evidentuar tri (3) dëgjime buxhetore, në të cilat nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar. Madje, numri i vogël i qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjimet buxhetore është pikërisht në kryeqytet. Numri i dëgjimeve buxhetore në këtë komunë është më i madh sesa numri total i qytetarëve që kanë marrë pjesë në këto dëgjime buxhetore.

Në anën tjetër, në Komunën e Hanit të Elezit, e cila është komunë shumë më e vogël se ajo e Prishtinës, ka një numër relativisht më të madh të qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore, pasi në dëgjimin e vetëm buxhetor të organizuar nga kjo komunë kanë marrë pjesë 28 qytetarë. Në këtë mënyrë, Komuna e Hanit të Elezit paraqet një progres në raport me komunat e tjera, pasi duke pasur parasysh se është komunë më e vogël, numrin e qytetarëve në dëgjimin e vetëm buxhetor e ka më të madh. Bazuar në monitorimin e buxhetimit edhe të viteve të kaluara nga INPO është parë se vazhdimisht dëgjimet buxhetore të Hanit të Elezit kanë qenë më të suksesshme. Në raport me këtë komunë, shihet se janë dy (2) arsye kryesore që ndikojnë në ngritjen e numrit të pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore të Hanit të Elezit. Fillimisht, në këtë komunë vet komuniteti është më homogjen, në krahasim p.sh. me komunitetin e Komunës së Prishtinës. Në anën tjetër, tash e disa vite shihet se qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit tanimë kanë ndërtuar një raport dhe respekt me Komunën, përkatësisht me Kryetarin e Komunës, i cili ka treguar përkushtim në këtë drejtim, i cili raport është kultivuar ndër vite.

Me këtë rast, këto gjetje të nxjerra nga monitorimi që IKD dhe INPO u ka bërë këtyre komunave, paraqet faktin se dëgjimet buxhetore, si forma më e rëndësishme e konsultimeve publike në hartimin e buxhetit, nuk po shfrytëzohen sa duhet dhe si duhet. Kjo mungesë e shtrirjes së dëgjimeve publike ia humbë kuptimin këtij organizimi, pasi më tepër paraqitet si takim me një grup të caktuar të qytetarëve, sesa me konsultim të tërësisë së qytetarëve, interesi i së cilës tërësi duhet të reflektohet në buxhetin e miratuar.

Për këto arsye, IKD dhe INPO konsiderojnë se të gjitha komunat dhe institucionet e tjera qendrore, duhet të apelojnë tek qytetarët, në drejtim të informimit të tyre për të drejtën dhe

mundësinë për të marrë pjesë në këto forma të konsultimeve publike, duke pasqyruar edhe rëndësinë e kësaj pjesëmarrje. Përtej kësaj, marrja parasysh e kërkesave të qytetarëve përçon mesazhin se qytetarët mund të jenë pjesë aktive e vendimmarrjes.

6. Planifikimi, Menaxhimi i kontratave dhe prokurimi në komuna

Krahas procesit të buxhetimit, IKD dhe INPO në nëntë (9) komunat kanë monitoruar edhe procesin e planifikimit të prokurimit, menaxhimit të kontratave dhe prokurimin.

Lidhur me planifikimin e prokurimit, sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik¹, së paku 30 ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzojë me shkrim te Zyrtaari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë.

Ndërsa planifikimi përfundimtar i cili është monitoruar nga IKD/INPO në bazë të të njëjtit ligj, kërkohet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë Agjencisë Qendrore të Prokurimit (tutje AQP), një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Tutje, Ligji kërkon që planifikimi i prokurimit për kontrata të furnizimit, shërbimeve dhe punëve të jetë i detajuar.

Kërkesën ligjore që plani i prokurimit të dërgohet në AQP brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal e kanë zbatuar të gjitha komunat e monitoruara, përveç Komunës së Rahovecit, e cila Planin e ka dërguar më 06.03.2020, apo 13 ditë para se të miratohet Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020. Nga monitorimi vërehet se nëse planet e prokurimit të komunave i përmbushin kërkesat ligjore, asnjëra komunë nuk e harton planin e prokurimit konform kërkesave të LPP-së, RrOUPP-it dhe Formularit B01.²

Mangësitë më së shumti janë evidente tek aktivitetet për furnizim ku sasitë dhe njësitë për këto aktivitete nuk plotësohen fare nga komunat, ose edhe ato komuna që i kanë plotësuar, rezultojnë se të dhënat nuk janë të sakta. Përveç Komunës së Pejës, Prishtinës dhe Vushtrrisë të cilat nuk kanë vendosur asnjë të dhënë rreth sasive apo njësive, komunat tjera janë munduar që t'i plotësojnë këto kërkesa, mirëpo gjatë hulumtimit rezultojnë që ato të dhëna janë të pasakta dhe kryesisht shabllone.

¹ Neni 8, paragrafi 1.

² Shih, neni 8, paragraf 2 të LPP-së <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>, lidhur me nenin 5 të RrUOPP https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A01_Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf dhe Formular B01 <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNeë.aspx?id=233>.

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë gjetur se shtatë (7) prej komunave të monitoruara (Prishtina, Peja, Vushtrria, Gjilani, Deçani, Juniku dhe Hani i Elezit), njërin nga dy aktivitetet e monitoruara, nuk e kanë paraparë në plan të prokurimit për vitin respektiv, derisa pesë (5) prej nëntë (9) komunave të monitoruara (Gjakova, Peja, Rahoveci, Juniku dhe Hani i Elezit), njërin nga dy aktivitetet e monitoruara i kanë përfshirë në planin e tyre të prokurimit për vitin përkatës duke paraparë vlerë më të ulët, krahasuar me vlerën e parashikuar në fazën e inicimit të aktivitetit.

Krahas të tjerave, sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë gjetur se në tri (3) raste, nga dy komuna të ndryshme (Junik dhe Hani i Elezit), janë identifikuar komisione të vlerësimit të ofertave, anëtarë të të cilëve, nuk kanë pasur kualifikimin e duhur.

Lidhur me menaxhimin e kontratave, IKD dhe INPO kanë gjetur se Komunitat në përgjithësi nuk i konsultojnë paraprakisht qytetarët për projekte të caktuara dhe shumica dërmuese e qytetarëve të anketuar nuk kanë njohuri për koston dhe kohëzgjatjen e kontratës, derisa mungon bashkëpunimi i duhur në mes të komunave dhe anëtarëve të Këshillave Lokalë, posaçërisht lidhur me projektet e caktuara.

Po ashtu, IKD dhe INPO kanë gjetur se Komuna e Prishtinës, tek kontrata “*Furnizimi me kiflet për nxënësit e klasave 1-5*”, përkundër që ekzistimi i sigurisë së ekzekutimit ka qenë kusht i Dosjes së Tenderit, e njëjta ka pranuar që të nënshkruajë kontratë pa një siguri të tillë derisa Komuna e Deçanit tek kontrata “*Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit*”, nuk ka arritur që të ekzekutojë pagesat tek Operatori Ekonomik në përputhje me kushtet e kontratës dhe nivelin e shërbimeve të kryera.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur gjetjet e IKD-së dhe INPO-së lidhur me secilën komunë sa i përket planifikimit të prokurimit, menaxhimit të kontratave dhe prokurimit.

6.1. Komuna e Prishtinës

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Prishtinës për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 205 aktivitete, 88 prej të cilave për punë, 66 për furnizime, 43 për shërbime dhe 8 për konkurs projektimi. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 2 prill 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Prishtinës ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa nuk ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Lidhur me zbatueshmërinë e planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se sa i përket kontratave për furnizime, Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të bëjë një planifikim të

arsyeshëm për aktivitetet për furnizim, ashtu siç kërkohet me Ligjin e Prokurimit Publik.³ Komuna nuk ka planifikuar fare njësi dhe sasi në Plan të prokurimit, ndërsa në fazat tenderuese vërehet se kemi njësi dhe sasi të caktuara për kontratat e monitoruara.

IKD dhe INPO gjejnë se Komuna e Prishtinës, për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 2,984,538.71€.

Gjithashtu, sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 88 aktivitete të planifikuara, mbulueshmëri në buxhet Komuna e Prishtinës nuk ka për pesë (5) aktivitete, me vlerë totale 1,280,000.00€.

Sipas gjetjeve të IKD-së dhe INPO-s, nga pesë aktivitetet e para për punë në kohëzgjatje prej 1-3 vite, një nga to nuk është e përfshirë fare në KAB, ndërsa për projektet tjera vërehet një respektim i KAB-it, përkatësisht në dy aktivitete vërehet vlerë identike, ndërsa në dy aktivitete tjera me KAB është planifikuar 30 mijë, respektivisht 50 mijë euro më shumë.

Lidhur me mënyrën e vlerësimit të tregut, Komuna e Prishtinës ka deklaruar se kjo bëhet përmes njësisë kërkuese.

Procesi i prokurimit

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

	Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Sigurimi fizik për objektet e Komunës së Prishtinës	616-20-3394-2-1-5	232,368
2	Ndërtimi i strehimores për qentë endacak dhe trajtimi i tyre	616-19-8855-5-2-1	150,000

Sipas gjetjeve, nga dy (2) aktivitetet e monitoruara në Komunën e Prishtinës, njëri është përfshirë në planin e prokurimit. Po ashtu, në këto dy (2) aktivitete, Komuna e Prishtinës ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktiviteteve kanë pasur kualifikimet e nevojshme. Në këto dy (2) aktivitete, nuk ka pasur njoftim për korrigjime të njoftimeve të publikuara, si dhe nuk ka pasur kërkesë për sqarime nga Operatorët Ekonomikë. Në këto dy (2) aktivitete, asnjë prej ofertuesve nuk është shpallur i papërgjegjshëm, derisa nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP nga ana e Operatorëve Ekonomikë.

³ Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 , Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

Në aktivitetin “Sigurimi fizik për objektet e Komunës së Prishtinës”, IKD dhe INPO kanë gjetur se Komuna e Prishtinës nuk ka zbatuar procedurën e duhur të prokurimit, duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke e kufizuar konkurrencën e lirë, si një parim i rëndësishëm në procedurën e prokurimit.

Lidhur me këtë, kjo komunë ka dhënë arsyen se: “Autoriteti Kontraktues shpall procedurë të negociuar deri në përfundimin e aktivitetit të ri për sigurim të objekteve, pasi që aktiviteti që është duke u zhvilluar në procedurë është në fazën ankimore në OSHP”.⁴ Sa i përket këtij aktiviteti, përveç që për këtë aktivitet të prokurimit është përdorur procedura e cila e minon konkurrencën si një parim shumë i rëndësishëm në prokurimin publik, në të njëjtën kohë komuna nuk ka qenë e interesuar që Operatori Ekonomik t’i përmbushë disa kërkesa të cilat sadopak do të ndikonin në kualitetin e shërbimit dhe në seriozitetin e kandidatit të ftuar për ofertim, ani pse për këtë çështje nuk është e obliguar me ligj.

Ndërsa, lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i strehimores për qentë endacak dhe trajtimi i tyre”, Komuna e Prishtinës për këtë aktivitet të prokurimit në kuadër të kërkesave për kapacitet teknik dhe profesional ka kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues të ketë edhe “Bazë për prodhimin e asfaltit, në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt”. Gjatë analizimit të punëve që pritët të kryhen në kuadër të implementimit të këtij projekti dhe pas analizimit të paramasës, vërejmë që Operatori Ekonomik nuk ka për obligim që askund të shtrojë asfalt dhe si rrjedhojë kërkesa e tillë është e paarsyeshme. Vendosja e kërkesave jo relevante dhe të paarsyeshme është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RrUOPP.

Komuna e Prishtinës, në aktivitetin “Sigurimi fizik për objektet e Komunës së Prishtinës”, ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe përkundër kësaj, e njëjta nuk ka arritur ta zbrësë asnjë cent. Kjo nënkupton se sa ka qenë vlера e parashikuar e kontratës, aq ka mbetur edhe pas negociatave.

Sa i përket sigurisë së tenderit, IKD dhe INPO gjejnë se kjo nuk është kërkuar në kontratën “Sigurimi fizik për objektet e Komunës së Prishtinës”.

Menaxhimi i kontratave

Lidhur me menaxhimin e kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Furnizim me kiflet për nxënësit e klasave 1-5	Titulli: Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria
Numri i prokurimit: 616-19-9113-1-1-1	Numri i prokurimit: 616-18-2602-5-1-1
Vlera e Kontratës: 247,752.00€	Vlera e kontratës: 362,878.72€

⁴ Arsytimi i dhënë nga Komuna e Prishtinës.

Sipas gjetjeve, Komuna e Prishtinës në njëren kontratë ka emëruar një menaxher i cili plotëson kualifikimet e kërkuara, derisa në kontratën tjetër nuk ka emëruar fare menaxher, pasi implementimi i kontratës nuk ka filluar.

Komuna e Prishtinës tek kontrata “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, nuk ka pasur siguri të ekzekutimit valide sepse kontrata zyrtarisht ka përfunduar më 13.12.2019, ndërsa siguria e ekzekutimit ka qenë deri më 27.12.2019. Sipas nenit 30.6 të RrUOPP kërkohet që “Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”.

Komuna e Prishtinës, gjithashtu tek kontrata “Furnizimi me kifle për nxënësit e klasave I-5”⁵, përkundër që ekzistimi i sigurisë së ekzekutimit ka qenë kusht i dosjes së tenderit, e njëjta ka pranuar siguri të ekzekutimit në kundërshtim me ligjin, përkatësisht në momentin kur është nënshkruar kontrata nuk ka pasur siguri, përkatësisht nuk ka pasur siguri valide. Kontrata është nënshkruar më 25.02.2020, ndërsa siguria e ekzekutimit është lëshuar më 27.02.2020, madje kjo siguri do të fillojë të vlej nga datë 25.05.2020 deri më 26.12.2020.

Në bazë të RrUOPP, kur kërkohet siguria e ekzekutimit e njëjta shndërrohet në parakusht për nënshkrim të kontratës, pra siguria e ekzekutimit duhet të ekzistojë në momentin e nënshkrimit të kontratës, në këtë rast Komuna e Prishtinës duke vepruar në kundërshtim me ligjin ka nënshkruar kontratë pa pasur paraprakisht një sigurim të tillë.⁶

Kontrata për punë e cila është monitoruar dhe për të cilën është zhvilluar vizita në terren është “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”. Nga vizita në terren vërehet se kontrata nuk është përmbushur në tërësi, përkatësisht pozicionet e caktuara nuk janë përmbushur sipas kontratës.⁷ Në fakt, disa pozicione sipas paramasës nuk janë implementuar fare, disa nga to pjesërisht, ndërsa ka pozicione që janë punuar më shumë sesa parashikimi me paramasë.

Nga 362,878.72€ sa ishte vlera e kontratës, deri në përfundim të projektit janë kryer punë në vlerë 352,522.95€, apo 10,355.77€ më pak se sa vlera e kontratës.

Gjithashtu, vërehet se pas përfundimit të projektit ka pasur ndërhyrje në të, përkatësisht janë prerë pjesë të caktuara të projektit për të hapur kanale për shtrirjen e gypave të ujitjes së pemëve dekorative nëpër park. Sipas Menaxherit të Kontratës kjo ndërhyrje është bërë nga Drejtoria e Parqeve dhe atë pas përfundimit të projektit meqë në këtë projekt nuk ishte

⁵ Shih kontratën dhe dosjen e tenderit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=796765.

⁶ Shih RrUOPP, neni 30, paragrafi 2, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁷ Shih kontratën, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=325970.

Pozicionet e pa përfunduara sipas paramasës janë: 1.1, 1.5, 1.7, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.14, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 4.3, 5.7, 6.9, 6.17, 7.2, 7.3, 8.1, 8.2, 11.20, pozicionet që janë vendosur më shumë se sa paramasa 7.5, ndërsa pozicionet të cilat nuk janë vendosur fare sipas paramasës 2.2, 2.3, 2.7, 2.8, 2.9, 9.7, 10.6, 11.18, 11.19, 11.26, 11.28, 11.29 dhe 11.31.

paraparë ujitja e pemëve. Edhe tualetet e dedikuara për nevoja të vizitorëve kanë qenë të mbyllura dhe të demoluara.

Të gjitha këto gjetje, dëshmojnë për një keqplanifikim të Komunës së Prishtinës, fillimisht për atë se shumë pozicione të kontratës nuk janë implementuar fare për faktin se sipas Menaxherit të kontratës nuk ka pasur nevojë, gjë që dëshmon keqplanifikim. Së dyti, pas gjithë kësaj pune, si pasojë e mosplanifikimit të ujitjes është dashur që të intervenohet në projektin e sapo përfunduar që të shtrihen gypat e ujitjes, duke dëmtuar në vende të caktuar projektin e parkut në këtë lagje. Qytetarët kanë deklaruar se kryesisht janë të kënaqur me këtë projekt dhe se i njëjti është projekt me prioritet, derisa kanë deklaruar se nuk janë këshilluar dhe nuk janë informuar lidhur me koston dhe kohëzgjatjen e projektit.

6.2. Komuna e Gjakovës

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Gjakovës për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 123 aktivitete, 53 prej të cilave për punë, 43 për furnizim dhe 27 për shërbime. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP brenda afatit ligjor, më 26 mars 2020.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Gjakovës ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa pjesërisht ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Lidhur me zbatueshmërinë e planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se sa i përket kontratave për furnizime, në vetëm në një aktivitet janë paraparë sasitë, ndërsa njësia matëse është paraparë në vetëm dy aktivitete, të cilat edhe ashtu nuk përputhen fare me sasitë dhe njësitë matëse gjatë fazës së tenderimit.

Aktiviteti “Furnizim me mjete dhe pajisje për shuarjen e zjarrit”, vërehet se ka një tejkallim të madh të vlerës së parashikuar, në fakt vlera e parashikuar gjatë fazës tenderuese është shumë më e vogël se ajo që ishte planifikuar. Të gjitha këto janë tregues se Komuna nuk ka arritur që planifikimin e prokurimit ta bëjë në bazë të kërkesave ligjore.

Sa i përket Komunës së Gjakovës, IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 2,952.082€.

Gjithashtu, sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 53 aktivitete për punë që ka planifikuar Komuna e Gjakovës, katër (4) prej tyre nuk mund të identifikohen në buxhet.

Sipas gjetjeve të IKD-së dhe INPO-së, pesë (5) aktivitetet e para për punë në kohëzgjatje prej 1-3 vite që ka inicuar Komuna e Gjakovës janë paraparë në KAB. Gjatë fazës tenderuese vlera e parashikuar është brenda parashikimeve në KAB, përkatësisht nuk është tejkaluar në KAB. Përjashtimisht aktiviteti “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ramoc”, njoftimi për kontratë është 19,931.98€ më i lartë sesa vlera e parashikuar në KAB, ndërsa aktiviteti “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, është inicuar me 200,000.00€, ndërsa në KAB për vitin 2020 dhe 2021, Komuna ka në dispozicion vetëm nga 100,000.00€, kurse për vitin 2022 ka 250,000.00€, në total 450,000.00€.

Sa i përket mënyrës së vlerësimit të tregut, Komuna e Gjakovës ka deklaruar se kjo bëhet përmes njësisë kërkuese.

Procesi i prokurimit

Lidhur me procesin e prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

	Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Digjitalizimi-shtyllat multifunkionale, qyteti i mençur dhe kamerat-kontratë dy vjeçare	632-19-4733-1-1-1	180,000
2	Ndërtimi i çerdheve në Komunën e Gjakovës	632-20-4633-5-2-1	197,578

Sa i përket procesit të prokurimit, dy (2) aktivitetet e monitoruara në Komunën e Gjakovës janë përfshirë në planin e prokurimit, por aktiviteti “Ndërtimi i çerdheve në Komunën e Gjakovës”, ka qenë i paraparë në vlerë më të vogël. Po ashtu, në këto dy (2) aktivitete, Komuna e Gjakovës ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa sa i përket kualifikimeve të nevojshme për anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktivitete, kjo komunë nuk na ka ofruar qasje në mënyrë që të bëhet një vlerësim në këtë drejtim.

Tek aktiviteti “Digjitalizimi-shtyllat multifunkionale, qyteti i mençur dhe kamerat-kontratë dy vjeçare”, ka pasur edhe formular për korrigjimin e njoftimit të publikuar fillimisht, edhe kërkesë për sqarime nga operatori ekonomik.

Ndërsa tek aktiviteti tjetër, “Ndërtimi i çerdheve në Komunën e Gjakovës”, nuk ka pasur njoftim për korrigjime të njoftimeve të publikuara dhe as kërkesë për sqarime nga operatorët ekonomikë.

Tek aktiviteti “Digjitalizimi-shtyllat multifunkionale, qyteti i mençur dhe kamerat-kontratë dy vjeçare”, nga katër (4) operatorë ekonomikë që kanë ofertuar, tre (3) janë shpallur të papërgjegjshëm, derisa ka pasur një kërkesë për rishqyrtim dhe një ankesë të parashtruar në OSHP nga ana e operatorit ekonomik.

Ndërsa, sa i përket aktivitetit tjetër “Ndërtimi i çerdheve në Komunën e Gjakovës”, ka pasur vetëm një (1) ofertues, derisa nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP nga ana e operatorit ekonomik.

Lidhur me sigurinë e tenderit, e njëjta ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, në të dy aktivitetet, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit nga autoriteti kontraktues.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët	Titulli: Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni
Numri i prokurimit: 632-20-3904-2-I-I	Numri i prokurimit: 632-20-1533-5-I-I
Vlera e Kontratës: 180 000,00€(vlera e parashikuar), çmim për njësi 0.66€	Vlera e kontratës: 626,653.15€

Sipas gjetjeve, Komuna e Gjakovës në të dy (2) kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Gjakovës është kontrata me titull “Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni”. Gjatë kësaj vizite janë vizituar pjesët e projektit që kanë të bëjë me ndërtimin dhe sanimin e trotuarit në rrugën “Sylejman Lleshi”, si dhe ndërtimin e sheshit “Ilir Soba”, në Gjakovë. Ajo çfarë është evidentuar nga kjo vizitë është fakti se në të dy lokacionet mungojnë ujëmbledhësit edhe pse të njëjtit kanë qenë të paraparë me paramasë, përkatësisht për tërë projektin kanë qenë të planifikuar njëzetepesë (25) ujëmbledhës.⁸ Përfunduar këtë vërejtje, në përgjithësi vërehet se punët tjera janë kryer në bazë të paramasës dhe kushteve të kontratës.

Qytetarët kanë deklaruar se kryesisht janë të kënaqur me këtë projekt dhe se i njëjti është projekt me prioritet, derisa kanë deklaruar se nuk janë këshilluar dhe nuk janë informuar lidhur me koston dhe kohëzgjatjen e projektit. Gjysma e qytetarëve të intervistuar kanë deklaruar se janë të kënaqur me këtë projekt, edhe pse kanë vlerësuar se ky projekt ka qenë me prioritet. Gjithashtu, të gjithë qytetarët e intervistuar kanë deklaruar se asnjëherë nuk janë konsultuar paraprakisht për këtë projekt dhe asnjëri nga ta nuk e din koston dhe kohëzgjatjen e kontratës.

⁸ Për më shumë, shih, kontratën dhe paramasën, e-prokurimi, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=972029.

Tek aktiviteti “Ndertimi i qerdheve në Komunën e Gjakovës”, IKD dhe INPO vlerësojnë se kriteret kanë pasur mundësi të ndikojnë që në këtë aktivitet të paraqitet vetëm një operator ekonomik. Kjo pasi kërkesat lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale të kërkuara nga ana e Komunës së Gjakovës mund të jenë konsideruar si shumë të larta nga ana e operatorëve të tjerë kontraktues, për çka edhe ka ofertuar vetëm një operator ekonomik, i cili edhe e ka fituar këtë kontratë.

6.3. Komuna e Pejës

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Pejës për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 115 aktivitete, 74 prej të cilave për punë, 26 për furnizime, 13 për shërbime dhe dy (2) për konkurs projektimi. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 1 prill 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të kësaj komune ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa nuk ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Lidhur me zbatueshmërinë e planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se sa i përket kontratave për furnizime, në asnjërin nga pesë (5) aktivitetet e monitoruara nuk janë të caktuara njësitë dhe sasi të për aktivitetet e planifikimit, e që në fakt komunat janë të obliguara që planin e prokurimit ta bëjnë në detaje të arsyeshme për furnizimet e ardhshme. Gjatë fazës tenderuese, gjithashtu vërehen disa njësi matëse të panjohura apo inekzistente si: rollne, paketim, tufë.

IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 134,595.90€.

Gjithashtu, sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 74 aktivitete për punë që ka planifikuar Komuna e Pejës, dy (2) prej tyre nuk mund të identifikohen në buxhet. Vlera e aktiviteteve që nuk mund të identifikohen në buxhet është 20,000.00€.

Sipas gjetjeve të IKD-së dhe INPO-s, pesë (5) aktivitetet e para për punë në kohëzgjatje prej 1-3 vite që ka inicuar Komuna e Pejës mund të identifikohen në KAB 2020-2022. Sa i përket vlerave të parashikuara, vërejmë se në asnjërin rast nuk kemi as për së afërmi vlerë të njëjtë të parashikuar.

Ndërsa, lidhur me mënyrën e vlerësimit të tregut, Komuna e Pejës ka deklaruar se kjo bëhet përmes njësisë kërkuese.

Procesi i prokurimit

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

	Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Ndërtimi i fushës së futbollit në Baran Komuna e Pejës	635-20-3448-5-1-1	521,012
2	Blerja dhe montimi i ashensorit në QKMF	635-20-4525-1-2-1	38,000

Lidhur me procesin e prokurimit, sipas IKD dhe INPO aktiviteti “Ndërtimi i fushës së futbollit në Baran Komuna e Pejës”, nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit, përderisa aktiviteti tjetër “Blerja dhe montimi i ashensorit në QKMF”, ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit, por në vlerë më të vogël.

Ndërsa, për të dy këto aktivitete, Komuna e Pejës ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktivitete kanë pasur kualifikimet e nevojshme. Në këto dy (2) aktivitete, nuk ka pasur kërkesa për sqarime nga operatorët ekonomikë, përderisa në aktivitetin “Ndërtimi i fushës së futbollit në Baran Komuna e Pejës”, autoriteti kontraktues ka publikuar korrigjim në njoftimet paraprake. Nga këto dy (2) aktivitete, tek aktiviteti “Ndërtimi i fushës së futbollit në Baran Komuna e Pejës”, janë shpallur katër (4) operatorë ekonomikë të papërgjegjshëm, përderisa tek aktiviteti tjetër ka qenë vetëm një (1) ofertues. Përkitazi me aktivitetin e parë ka pasur një (1) kërkesë për rishqyrtim.

Lidhur me sigurinë e tenderit, e njëjta ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, në të dy aktivitetet, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit nga autoriteti kontraktues.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Furnizim me material shpenzues për barnatoren qendrore të QKMF-së	Titulli: Ndërtimi i rrugës “Drelaj – Leqinat” në Rugovë
Numri i prokurimit: 635-20-3528-1-2-1	Numri i prokurimit: 635-20-2895-5-1-1
Vlera e Kontratës: 26,988.00€	Vlera e kontratës: 548,958.18€

Lidhur me menaxhimin e Kontratave, Komuna e Pejës në të dy kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Pejës është kontrata me titull “Ndërtimi i rrugës “Drelaj – Leqinat” në Rugovë”.

Në bazë të vizitave në terren ende nuk është punuar asgjë, rruga e paraparë për t’u ndërtuar ka qenë e mbuluar krejtësisht me borë dhe kontrata është nënshkruar në fund të tetorit, përkatësisht rreth pesë muaj më parë.

Në pyetjen drejtuar menaxherit të kontratës se përse aty nuk është punuar asgjë, përgjigja ka qenë se puna ende nuk ka filluar për shkak të kushteve atmosferike, kurse sipas tij janë kryer vetëm punët përgatitore. Bazuar në përgjigjet e qytetarëve të intervistuar, vërejmë se qytetarët edhe përkundër asaj se e konsiderojnë projekt me prioritet, shumica prej tyre nuk janë të kënaqur me projektin dhe shumica nga ta nuk janë këshilluar paraprakisht për këtë projekt, ndërsa një (1) nga tre (3) qytetarët e intervistuar nuk e kanë ditur koston dhe kohëzgjatjen e kontratës. Qytetarët gjithashtu janë pyetur edhe për ankesat lidhur me këtë projekt dhe nga tre (3) qytetarët e intervistuar, të gjithë kanë pasur ankesa të cilat kanë të bëjnë me mosfillimin e implementimit të projektit, ndërsa njëri nga ta ka deklaruar se ankesën e ka adresuar tek menaxheri i kontratës.

6.4. Komuna e Rahovecit

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Rahovecit për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 47 aktivitete, 26 prej të cilave për punë, 10 për furnizim dhe 1 për shërbime. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP jashtë afatit ligjor, pasi ky planifikim është dërguar në AQP më 6 mars 2020, apo më 26 mars 2020.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Rahovecit ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa pjesërisht ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Lidhur me zbatueshmërinë e planit të prokurimit, Komuna e Rahovecit nga pesë (5) aktivitetet e monitoruara, njërin nuk e ka fare të përfshirë në Plan të prokurimit, pra, bëhet fjalë për aktivitetin “Furnizim me flamuj, shtiza, kurora dhe buqeta lulesh për aktivitetet perkujtimore” me vlerë 8,170.00€.

Gjithashtu, vërehet se në Plan të prokurimit tek pjesa ku është dashur të vendoset njësia është përdorur shabllonin “komplet” vetëm sa për të mbushur kolonën dhe gjithashtu njësine matëse “1,00”. Me përjashtim të aktivitetit “Furnizim me pajisje mjekësore për laborator për nevoja të QKMF -së”, të gjitha aktivitetet tjera të monitoruara nuk përputhen me fazën tenderuese.

IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 70,000€.

Gjithashtu, sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 26 aktivitete për punë që ka planifikuar Komuna e Rahovecit, tre (3) prej tyre nuk mund të identifikohen në buxhet. Vlera e aktiviteteve që nuk mund të identifikohen në buxhet është 70,000.00€.

Komuna e Rahovecit e ka votuar KAB-in 2020-2022, mirëpo njëjtë si në rastin e Komunës së Gjilanit nuk i përshkruan në mënyrë të detajuar shpenzimet për projektet kapitale për periudhën 3 vjeçare, mirëpo vetëm në shifra të përgjithshme paraqiten shpenzimet për këtë kategori.⁹ Sidoqoftë, aktivitetet për punë 1-3 vjet që ka inicuar kjo komunë janë: “Rrënimi i objekteve pa leje si dhe konfiskimi i mallrave”, “Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë”, “Intervenimet emergjente në infrastrukturë në Komunën e Rahovecit”, “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në Komunën e Rahovecit”, dhe “Ndërtimi i QMF-së në Apterushë”. Vlera totale e parashikuar e këtyre aktiviteteve është 511,565.38€. Mirëpo, për arsyet e cekura më lartë krahasimi me KAB ka qenë i pamundur.

Lidhur me mënyrën e vlerësimit të tregut, Komuna e Rahovecit ka deklaruar se kjo bëhet përmes njësisë kërkuese.

Procesi i prokurimit

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

	Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit – shtretërit shtëpiak	623-20-904-2-1-1	420,396
2	Ndërtimi i semaforëve të rinj	623-20-3817-5-2-1	55,430

Lidhur me këtë proces, të dy aktivitetet e monitoruara në këtë komunë, kanë qenë të përshtirë në planin e prokurimit, por në vlerë më të vogël. Ndërsa, për të dy këto aktivitete, Komuna e Rahovecit ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktiviteteve kanë pasur kualifikimet e nevojshme.

Në asnjë nga këto aktivitete nuk ka pasur korrigjime nga ana e autoritetit kontraktues, përndryshe tek aktiviteti “Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin

⁹ KAB 2020-2022, Komuna e Rahovecit <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2020/04/KAB-2020-2022.pdf>

e projektit – shtretërit shtëpiak”, ka pasur një kërkesë për sqarime nga ana e operatorit ekonomik. Për sa i përket aktivitetit “Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastruktures për funksionalizimin e projektit – shtretërit shtëpiak”, asnjë nga ofertuesit nuk është shpallur i papërgjegjshëm, përderisa tek “Ndërtimi i semaforëve të rinj”, janë shpallur të papërgjegjshëm dy (2) nga tre (3) operatorë ekonomikë që kanë ofertuar. Përkitazi me aktivitetin e parë nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim, përderisa tek aktiviteti tjetër ka pasur dy kërkesa të tilla. Ndërsa, në OSHP nuk ka paraqitur ankesë asnjë operator ekonomik.

Sa i përket sigurisë së tenderit, e njëjta ka qenë valide lidhur me afatin kohor që është kërkuar në të dy aktivitetet, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit nga autoriteti kontraktues.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Furnizim me filma për rentgen për nevojat e QKMF – së	Titulli: Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në komunën e Rahovecit
Numri i prokurimit: 623-20-2682-1-2-1	Numri i prokurimit: 623-19-6628-5-1-1
Vlera e Kontratës: 29,000.00€	Vlera e kontratës: 438,668.29€

Sipas gjetjeve, Komuna e Rahovecit në të dy kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Rahovecit është kontrata me titull “Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në komunën e Rahovecit”. Nga monitorimi në terren, konkretisht, vizitat në fshatrat Pataqan i Ulët, Fortesë/Bellacërkë, si dhe në Rahovec, IKD dhe INPO kanë parë se në fshatin “Fortesë”, në dy lokacione të ndryshme, punët kanë përfunduar, ndërsa në “Pataqan të Ulët”, punët veçse kishin filluar, përkatësisht vetëm punët përgatitore, të pastrimit të hapësirës dhe sigurimit të kanaleve të nevojshme për ato pjesë, përderisa instalimi i tyre ende nuk ishte kryer, por ishte në proces.

Kujtojmë se projekti është tre (3) vjeçar, andaj edhe shumica e punëve ishin ende në proces e sipër. Në përgjithësi, qytetarët kryesisht kanë qenë të kënaqur me këtë projekt dhe se sipas tyre ky projekt ka qenë prioritet. Sa i përket asaj se a janë këshilluar qytetarët për këtë projekt, nga gjashtë qytetarë të intervistuar vetëm dy (2) kanë deklaruar që jo, ndërsa tre (3) qytetarë nuk e kanë ditur kohëzgjatjen dhe vlerën e kontratës.

6.5. Komuna e Vushtrrisë

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Vushtrrisë për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 68 aktivitete, 14 prej të cilave për punë, 35 për furnizime dhe 19 për shërbime. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 3 prill 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Vushtrrisë ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa nuk ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Lidhur me zbatueshmërinë e planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se Komuna e Vushtrrisë nga pesë (5) aktivitetet e testuara, dy (2) prej tyre i ka zhvilluar jashtë planifikimit, respektivisht të njëjtat nuk mund të identifikohen në Plan të prokurimit. Bëhet fjalë për projektin “Furnizimi me pako higjienike dhe ushqimore për ndihmë të familjeve në nevojë” dhe “Furnizim me pemë dhe perime”, të cilët vlerën totale e kanë 50,140.50€.

Pra, Komuna e Vushtrrisë mbi 50,000.00€ euro do t'i shpenzojë pa i planifikuar fare paraprakisht. Nga tri aktivitetet që ka inicuar Komuna dhe që janë në planifikim të prokurimit, aktiviteti “Furnizimi dhe montimi i serave me sipërfaqe 50m²”, nuk ka vlerë të njëjtë e as të përafërt me Planin e prokurimit, përkatësisht Komuna ka planifikuar se ky aktivitet do të kushtoj 80,000.00€, ndërsa procedurat janë hapur me vlerë të parashikuar 108,996.50€. Gjithashtu, vërejmë se Komuna nuk ka vendosur fare sasi dhe njësi në Plan të prokurimit, ndërsa në fazat tenderuese vërejmë që kemi njësi dhe sasi të ndryshme gjë që nuk janë të paraqitura në Plan të prokurimit. Të gjitha këto të gjetura dëshmojnë se Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur që të hartojë një planifikim konform nevojave reale dhe kërkesave ligjore.

IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 259,014.70 €.

Sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se 14 aktivitete të planifikuara janë të bazuara në buxhet.

Sipas gjetjeve të IKD-së dhe INPO-s, nga pesë (5) aktivitetet e para për punë në kohëzgjatje prej 1-3 vite, një nga to nuk është e përfshirë fare në KAB. Në dy aktivitetet e para vërejmë se kemi tejkalim të vlerës së parashikuar, respektivisht procedurat tenderuese kanë filluar me vlerë më të madhe të parashikuar sesa ajo që është parashikuar në KAB, ndërsa në dy aktivitetet tjera është e kundërta.

Sa i përket mënyrës së vlerësimit të tregut, Komuna e Vushtrrisë ka deklaruar se kjo bëhet sipas prokurimeve paraprake apo të njëjta.

Procesi i prokurimit

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

	Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Furnizim me pajisje për përkrahje të bizneseve sipas LOT1 dhe LOT2	644-19-6312-1-1-1	132,726
2	Rregullimi i sheshit Adem Jashari në Vushtrri	644-20-2597-5-2-1	425,711

Sipas gjetjeve, aktiviteti “Rregullimi i sheshit Adem Jashari në Vushtrri”, nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit, përderisa aktiviteti tjetër “Furnizim me pajisje për përkrahje të bizneseve sipas LOT1 dhe LOT2”, ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit. Ndërsa, për të dy këto aktivitete, Komuna e Vushtrrisë ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa sa i përket kualifikimeve të nevojshme për anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktivitete, Komuna e Vushtrrisë nuk na ka ofruar qasje në mënyrë që të bëhet një vlerësim në këtë drejtim.

Në këto dy (2) aktivitete, nuk ka pasur kërkesa për sqarime nga operatorët ekonomikë, përderisa në aktivitetin “Rregullimi i sheshit Adem Jashari në Vushtrri”, autoriteti kontraktues ka publikuar korrigjim në njoftimet paraprake. Nga këto dy (2) aktivitete, tek aktiviteti “Furnizim me pajisje për përkrahje të bizneseve sipas LOT1 dhe LOT2”, është shpallur një (1) operator ekonomik i papërgjegjshëm nga dy që kanë ofertuar, përderisa tek aktiviteti tjetër ka qenë vetëm një ofertues. Për sa i përket kësaj komune, nga operatorët ekonomikë nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim dhe as ankesa në OSHP.

Lidhur me sigurinë e tenderit, tek të dy (2) aktivitetet, pra Furnizim me pajisje për përkrahje të bizneseve sipas LOT1 dhe LOT2” dhe “Rregullimi i sheshit Adem Jashari në Vushtrri”, e njëjta ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, e po ashtu edhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit nga autoriteti kontraktues.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsitë	Titulli: Asfaltimi i rrugëve lokale në qytet
---	--

Numri i prokurimit: 644-19-4463-5-1-1	Numri i prokurimit: 644-19-1843-5-1-1
Vlera e Kontratës: 1,800,000.00€ (vlera e parashikuar), çmim për njësi 72.4	Vlera e kontratës: 581.357,85

Lidhur me menaxhimin e kontratave, Komuna e Vushtrrisë në të dy kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Vushtrrisë është kontrata me titull “Asfaltimi i rrugëve lokale në qytet”. Vizita është zhvilluar në dy rrugë kryesore, Rruga “Faruk Beqiri” dhe “Nexhip e Ferat Draga”. Nga vizita në vendin ku janë kryer punët, vërejmë se cilësia nuk ka qenë e duhura, sepse rruga që dukej që sapo është shtruar ka pasur gropa dhe pjesë të parregulluara. Po ashtu edhe trotualet kanë qenë shumë të lartë dhe të papërshtatshëm për personat me nevoja të veçanta.

Bazuar në përgjigjet e qytetarëve të intervistuar, pesë (5) nga gjashtë (6) qytetarët kanë pasur ankesa, të cilat kanë pasur të bëjnë me vonesa në kryerjen e punëve, cilësi të dobët të punimeve dhe qasje jo të lehtë për persona me aftësi të kufizuara. Si komente shtesë qytetarët kanë apeluar që menaxherët të mos pranojnë punë që nuk ofrojnë qasje për persona me aftësi të kufizuara, kanë kërkuar mbikëqyrje më të madhe në mënyrë që punët të jenë cilësore. Asnjëri nga këta qytetarë të intervistuar nuk është këshilluar lidhur me këtë projekt dhe asnjëri nga ta nuk e din koston dhe kohëzgjatjen e kontratës.

6.6. Komuna e Gjilanit

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Gjilanit për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 58 aktivitete, 16 prej të cilave për punë, 29 për furnizime, 12 për shërbime dhe një (1) konkurs projektimi. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 2 prill 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Gjilanit ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa pjesërisht ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Lidhur me zbatueshmërinë e planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se Komuna e Gjilanit ka zhvilluar procedura të prokurimit për një aktivitet të furnizimit të cilën nuk e ka pasur fare në planifikim, bëhet fjalë për aktivitetin “Furnizim me farë misri”, me vlerë 20,000.00€. Gjithashtu, aktiviteti “Furnizim me veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit”, ka dallim të theksuar në mes vlerës së parashikuar në Plan dhe asaj gjatë inicimit të aktivitetit.

Edhe tek kjo komunë vërehet përdorimi i shabllonit “komplet” tek njësia matëse dhe se i njëjti fare nuk është i aplikueshëm gjatë fazave të tenderimit. Kjo dëshmon se Komuna sasitë dhe njësitë e vendosura në Plan nuk i ka reale, mirëpo vetëm i ka plotësuar formalisht. Gjithashtu, Komuna e Gjilanit ka përdorur disa njësi që nuk njihen si njësi matëse siç janë: thasë dhe set.

IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 2,307,998.18€.

Sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 16 aktivitete, nëntë (9) prej tyre, vlera e të cilëve është 5,064,157.00 euro, nuk mund të identifikohen në buxhet.

Sipas gjetjeve të IKD-së dhe INPO-s, Komuna e Gjilanit e ka të miratuar KAB-in 2020-2022, mirëpo në këtë dokument nuk mund të identifikohen aktivitetet për punë, përkatësisht nuk janë të paraqitura projektet për punë dhe financimi i tyre për tre vite ashtu siç planifikohet në KAB dhe si rrjedhojë pasqyrimi i respektimit të këtij dokumenti kaq të rëndësishëm ka qenë i pamundur.

Sa i përket mënyrës së vlerësimit të tregut, Komuna e Gjilanit ka deklaruar se kjo bëhet përmes njësive kërkuese.

Procesi i prokurimit

Lidhur me procesin e prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

Aktiviteti		Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Studim fizibiliteti -përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndriçimit publik në Komunën e Gjilanit	651-20-507-2-2-2	20,000
2	Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve	651-20-2311-5-1-1	760,278

Sa i përket procesit të prokurimit, aktiviteti “*Studim fizibiliteti -përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndriçimit publik në Komunën e Gjilanit*”, ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit, përderisa aktiviteti tjetër “*Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve*”, nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit të komunës së Gjilanit.

Ndërsa, për të dy këto aktivitete, Komuna e Gjilanit ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktiviteteve kanë pasur kualifikimet e nevojshme. Në aktivitetin “*Studim fizibiliteti -përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndriçimit publik në Komunën e Gjilanit*”, nuk ka pasur as kërkesë për sqarime nga ana e operatorit ekonomik dhe as korrigjime nga autoriteti kontraktues. Në anën

tjetër, tek aktiviteti “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, ka pasur edhe kërkesë për sqarime, e po ashtu edhe korrigjime nga autoriteti kontraktues.

Për sa i përket aktivitetit të parë, ka pasur vetëm një ofertues, ndërsa, tek aktiviteti “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, 15 operatorë ekonomikë janë shpallur të papërgjegjshëm, nga 16 sa kanë ofertuar. Përkitazi me aktivitetin e parë nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim, përderisa tek aktiviteti tjetër ka pasur katër (4) kërkesa të tilla. Ndërsa, në OSHP janë paraqitur gjashtë (6) ankesa.

Sa i përket sigurisë së tenderit, për aktivitetin e parë nuk është kërkuar. Ndërsa tek aktiviteti “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, e njëjta ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit nga autoriteti kontraktues.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Furnizim me material higjieniko sanitar	Titulli: Ndërtimi i tregut të gjelbër
Numri i prokurimit: 651-19-6067-1-1-1	Numri i prokurimit: 651-18-5108-5-1-1
Vlera e Kontratës: 201,600.00€	Vlera e kontratës: 871,173.42€

Sipas gjetjeve, Komuna e Gjilanit në njëren kontratë ka emëruar një (1) menaxher i cili plotëson kualifikimet e kërkuara, derisa në kontratën tjetër, atë “Ndërtimi i tregut të gjelbër”, nuk na kanë ofruar qasje në dokumentet e këtij tenderi dhe as në informatën se kush është menaxher.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Gjilanit është kontrata me titull “Ndërtimi i tregut të gjelbër”. Gjatë vizitës në vendpunimet ku është duke u realizuar projekti, kemi vërejtur se zbatimi i kontratës është bërë pjesërisht dhe se janë ndërprerë punimet. Punët që janë kryer janë punët përgatitore të dheut, zhavorit, muratimit dhe punët e kulmit pjesërisht, mirëpo nuk janë realizuar ende punët e hidroizolimit, suvatimit, nivelizimit dhe mvëshjes së dyshemesë dhe mureve, punët e zdrukthëtarisë dhe punët e fasadës. Në bazë të kontratës punët do të duhej të përfundonin në vitin 2019, mirëpo e kundërta vërtetohet gjatë vizitës, pra kontrata ende nuk është implementuar. Përgjithësisht, nga të dhënat e intervistat përfundojmë se qytetarët nuk janë të kënaqur me këtë projekt edhe pse i njëjti sipas tyre ka qenë i domosdoshëm. Vetëm dy (2) qytetarë nga gjashtë (6) sa kanë qenë të anketuar janë të kënaqur me këtë projekt, ndërsa vetëm dy prej tyre e dinin koston dhe

kohëzgjatjen e kontratës. Nga Komuna e Gjilanit paraprakisht lidhur me këtë projekt ishin konsultuar katër nga gjashtë qytetarët e anketuar.

6.7. Komuna e Deçanit

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Deçanit për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 30 aktivitete, 10 prej të cilave për punë, 11 për furnizime, tetë (8) për shërbime dhe një (1) konkurs projektimi. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 3 prill 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Deçanit ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa pjesërisht ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Sa i përket zbatueshmërisë së planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se Komuna e Deçanit vlerat e parashikuara të aktiviteteve për furnizim i ka konform Planit të prokurimit. Sa i përket vlerave lidhur me njësitë dhe sasi të gjitha aktivitetet e testuara ka një dallim të madh në atë që është planifikuar me atë se çfarë njësi matëse dhe sasi janë evidentuar në fazat tenderuese. Komuna e Deçanit në asnjërën nga aktivitetet e paraqitura në tabelë njësitë dhe sasi nuk i ka të njëjta me Planin e prokurimit. Pra, Komuna nuk ka arritur që të planifikojë në detaje të arsyeshme aktivitetet për furnizim.

IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në Plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 560,500 €.

Sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se tri (3) aktivitete, vlera e të cilëve është 160.000 euro, nuk mund të identifikohen në buxhet.

Sipas gjetjeve të IKD-së dhe INPO-s, Komuna e Deçanit deri më 19.11.2020 ka inicuar vetëm tri aktivitete për punë me kohëzgjatje 1-3 vite, me vlerë totale 544,700.00€. Nga analizimi i KAB-it të Komunës së Deçanit dhe aktiviteteve në fjalë, rezulton që asnjëri nga këto aktivitete për punë nuk figuron në KAB.

Sa i përket mënyrës së vlerësimit të tregut, Komuna e Deçanit ka deklaruar se kjo bëhet përmes njësisë kërkuese.

Procesi i prokurimit

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

Aktiviteti		Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Ndërtimi i rrugës në Bjeshkën e Strelcit-Deçan	631-19-3836-5-1-1	3,222,959
2	Furnizim me e – kiosk	631-19-5026-1-2-1	15,000

Lidhur me këtë proces, aktiviteti “Furnizim me e – kiosk”, ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit, përderisa aktiviteti tjetër “Ndërtimi i rrugës në Bjeshkën e Strelcit-Deçan”, nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit të Komunës së Deçanit. Ndërsa, për të dy këto aktivitete, Komuna e Deçanit ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktiviteteve kanë pasur kualifikimet e nevojshme. Në aktivitetin “Furnizim me e – kiosk” nuk ka pasur as kërkesë për sqarime nga ana e operatorit ekonomik dhe as korrigjime nga autoriteti kontraktues. Në anën tjetër, tek aktiviteti “Ndërtimi i rrugës në Bjeshkën e Strelcit-Deçan”, nuk ka pasur kërkesa për sqarime, por ka pasur korrigjime nga autoriteti kontraktues.

Për sa i përket aktivitetit të dytë, ka pasur vetëm një ofertues. Ndërsa, tek aktiviteti “Ndërtimi i rrugës në Bjeshkën e Strelcit-Deçan”, shtatë (7) operatorë ekonomikë janë shpallur të përgjegjshëm, nga tetë (8) sa kanë ofertuar. Përkitazi me këtë aktivitet nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim, përderisa tek aktiviteti tjetër ka pasur katër (4) kërkesa të tilla. Ndërsa, në OSHP janë paraqitur tri ankesa.

Sa i përket sigurisë së tenderit, për të dy aktivitetet në këtë komunë, ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO ka përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit	Titulli: Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan
Numri i prokurimit: 631-20-1999-2-1-1	Numri i prokurimit: 631-19-6725-5-1-1
Vlera e Kontratës: 1,933,111.00€	Vlera e kontratës: 452,456.90€

Sipas gjetjeve, Komuna e Deçanit në të dy kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Deçanit është kontrata me titull “Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan”. Gjatë vizitës është vërejtur se ka mospërputhje në mes të punëve që janë zhvilluar në krahasim me pagesat, përkatësisht faturat e lëshuara nga operatori ekonomik. Lidhur me këtë çështje, nga operatori ekonomik i kontraktuar janë deklaruar se kanë shfrytëzuar periudhën e pandemisë, përkatësisht uljen e çmimeve për materialet ndërtimore dhe punët i kanë zhvilluar më shpejt sesa plani dinamik.

Gjetje tjetër është edhe fakti që kjo qendër është mjaft larg nga qendra e qytetit, përkatësisht qasja për deri tek kjo qendër është mjaft e vështirë. Qytetarët e Komunës së Deçanit përgjithësisht kanë deklaruar se janë të kënaqur me këtë projekt dhe se e shohin si të mirëseardhur dhe me prioritet, ndërsa mësohet se qytetarët nuk janë këshilluar paraprakisht për këtë projekt dhe se nuk kanë asnjë njohuri për kohëzgjatjen dhe koston e tij.

6.8. Komuna e Junikut

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Junikut për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 44 aktivitete, 12 prej të cilave për punë, 17 për furnizime, 14 për shërbime dhe një (1) konkurs projektimi. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 2 prill 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Junikut ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa pjesërisht ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Sa i përket zbatueshmërisë së planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se në Komunën e Junikut dy (2) nga pesë (5) aktivitetet e testuara nuk kanë njësi dhe sasi të njëjtë, respektivisht nuk i kanë ashtu siç janë planifikuar me Plan të prokurimit. Gjithashtu, dy nga pesë aktivitetet nuk kanë vlerë të njëjtë të parashikuar, pra, vlera e tyre dallon nga planifikimi me atë në fazën tenderuese. Tek kjo komunë në Plan të prokurimit, në vend të sasisë vërehet përdorimi i shabllonit “1”, pra numrit një që lë të kuptohet që sasia është 1, mirëpo kjo bie poshtë dhe vërtetohet faktin se ky është një shabllon sepse tek aktiviteti “Furnizim me dru për shkollat e Komunës së Juniku”, në planifikim sasia është 1, ndërsa gjatë fazës tenderuese sasia është 340 m³. Pra, shablloni “1” është përdorur vetëm për të mbushur kolonat. Aktiviteti “Furnizim me klima për objektin e QKMF” të cilën e ka inicuar komuna e Junikut nuk është fare në Plan të prokurimit.

Sa i përket Komunës së Junikut, IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 499,460€.

Sa i përket aktiviteteve për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 17 aktivitete, shtatë (7) prej tyre, vlera e të cilëve është 347,500.00€, nuk mund të identifikohen në buxhet.

Sa i përket aktiviteteve për punë me kohëzgjatje 1-3 vjet, IKD dhe INPO gjejnë se në Komunën e Junikut është identifikuar vetëm aktiviteti “Rehabilitimi i rrugëve lokale”, i cili në KAB do të ketë financim total 70,000.00€, përkatësisht 30,000.00€ dhe nga 20,000.00€ për vitin 2021 dhe 2022. Të dhënat e IKD dhe INPO dëshmojnë se vlera me të cilën është inicuar aktiviteti është 10,000.00€ më e lartë se sa parashikimet që janë bërë në KAB-in e Komunës së Junikut.

Sa i përket mënyrës së vlerësimit të tregut, Komuna e Junikut ka deklaruar se kjo bëhet sipas prokurimeve paraprake apo të njëjta.

Procesi i prokurimit

Sa i përket procesit të prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

	Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë	636-19-5225-5-1-1	4,856,000
2	Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike	636-19-3827-1-2-1	60,000

Sipas gjetjeve, aktiviteti “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit, përderisa aktiviteti tjetër, ai “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike”, ka qenë i përfshirë, por në vlerë më të vogël. Ndërsa, në këto dy (2) aktivitete, Komuna e Junikut ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa sa i përket kualifikimeve të nevojshme për anëtarët e komisioneve vlerësuese në këto dy (2) aktiviteteve, kemi gjetur se tek aktiviteti “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike”, anëtarët e këtij komisioni kanë pasur kualifikimet e nevojshme, por këto kualifikime nuk i kanë pasur anëtarët e komisionit vlerësues tek aktiviteti tjetër.

Në këto dy (2) aktivitete, nuk ka pasur korrigjime të njoftimeve të publikuara, përderisa tek aktiviteti “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike”, ka pasur kërkesë për sqarime nga operatori ekonomik. Në këto dy (2) aktivitete, janë shpallur ofertues të përgjegjshëm. Madje tek aktiviteti i parë, “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, nga tre ofertues sa kanë qenë fillimisht të gjithë operatorët ekonomik janë gjetur të përgjegjshëm, por pas rivlerësimeve të vazhdueshme si pasojë e vendimeve të OSHP-së, ky autoritet kontraktues kishte shpallur të gjithë të papërgjegjshëm, ndërsa pas ankesave tjera, operatori ekonomik “Joos&Krasniqi-bazë” sh.p.k. ishte shpallur fitues, kurse Konsorciumi i Operatorëve Ekonomik “Arfa Group SH.P.K & Euroasphalt” si operator pa interes (në listë të zezë nga OSHP-ja), ndërsa Lika Trade Sh.p.k., administrativisht i papërgjegjshëm.

Ndërsa tek aktiviteti “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike”, nga pesë (5) ofertues, katër (4) janë shpallur të papërgjegjshëm. Në secilin nga këto dy aktivitete ka pasur kërkesa

për rishqyrtim, ku tek aktiviteti “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, ka pasur tri (3) kërkesa për rishqyrtim, përderisa tek aktiviteti “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike” ka pasur vetëm një (1) kërkesë për rishqyrtim. Sa i përket ankesave në OShP, për aktivitetin “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë” ka pasur gjashtë (6) ankesa në OSHP, kurse në këtë organ ka pasur vetëm një (1) ankesë sa i përket aktivitetit “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike”.

Sa i përket sigurisë së tenderit, IKD dhe INPO gjejnë se kjo nuk është kërkuar në kontratën “Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike”, ndërsa tek aktiviteti tjetër ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Transporti i nxënësve me autobus në relacionin, lagjja Agim Ramadani - shkollë dhe anasjelltas	Titulli: Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes
Numri i prokurimit: 636-20-1189-2-2-1	Numri i prokurimit: 636-19-5776-5-1-1
Vlera e Kontratës: 35,769.60€	Vlera e kontratës: 777,777.77€

Lidhur me menaxhimin e kontratave, Komuna e Junikut në të dy kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Pas analizës së sigurisë së ekzekutimit, gjetjet dëshmojnë se Komuna e Junikut tek kontrata “Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes”, ka pranuar siguri të tenderit për periudhë kohore më të shkurtër sesa minimumi i lejuar me ligj, përkatësisht siguria e ekzekutimit është valide vetëm njëzeteshtatë (27) ditë pas përfundimit të kontratës. Kontrata parashihet të përfundojë më 03.11.2022, ndërsa siguria e ekzekutimit është deri më 30.11.2022, pra njëzeteshtatë (27) ditë, e jo së paku tridhjetë (30) sa kërkohet me Ligj.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Junikut është kontrata me titull “Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes”. Gjatë vizitës në terren kemi evidentuar shkelje të shumta të cilat janë në kundërshtim me paramasën dhe me pagesat e kryera. Këto shkelje i gjeni të listuara më poshtë:

1. Sipas paramasës pozicioni 1.2 “Furnizimi me material dhe montimi i rrethojës së përkohshme për të mbuluar vizualisht vend punishten”. Rrethoja duhet të punohet nga konstruksioni i metalit dhe të mveshet me llamarinë. Lartësia e rrethojës duhet të jetë 3m”. Konstatim: Ky pozicion ka kushtuar 7,620.00€, ndërsa sipas asaj që kemi parë në

teren konstruksioni i rrethojës është nga druri dhe jo nga hekuri dhe lartësia e rrethojës nuk është 3 metër por 2 metër.

2. Pozicioni I.3 “Punimi i tabelës sinjalizuese ku duhet të përfshihen informatat: Projekti, investitori dhe punë kryesi. Në çmim të përfshihen edhe tabelat sinjalizuese që paralajmërojnë rrezikun me mbishkrim “kantier ndërtimi”. Tabela informuese duhet të jetë me dimensione 200x300cm, ndërsa tabela e paralajmërimit duhet të jetë me dimensione 50x80 cm dhe duhet të vendoset në rrethojën e punishtes”. Konstatim: Secila nga këto tabela, komunës i ka kushtuar nga 10,000.00€, në total 20,000.00€ dhe asnjëra nga to nuk e ka specifikat sipas paramasës, madje çmimi real në treg i këtyre tabelave sillet prej 100-150€.
3. Pozicioni I.4 “Furnizimi dhe vendosja e objektit të përkohshëm montues që duhet të përmban: Një zyre për konsulta të ndryshme dhe dy tualete. Zyra duhet të ketë dimensione 3x4metër”. Konstatim: Zyra nuk është në vendpunishte edhe pse e njëjta është paguar 5,000.00€.
4. Pozicioni I0.1 “Furnizimi transporti dhe montimi i dritareve njëkrahëshe nga druri i bungut dhe komplet me mekanizëm, bagllama dhe dorëz për hapje dhe mbyllje, me hapje normale dhe kiper”. Konstatim: Për këto dritare komuna ka paguar 9,600.00€, ndërsa nga shikimi i vendpunishtes rezulton që dritaret nuk janë nga druri por nga plastika (PVC).

Lidhur me këto gjetje, IKD dhe INPO përveç intervistës me menaxherin e kontratës nëpërmjet e-mailit, të njëjtat gjetje ia ka dërguar edhe organeve komunale për të kërkuar sqarime, ndërsa të njëjtit përgjegjësinë e kanë bartur tek menaxheri i kontratës. Menaxheri i kontratës gjatë bisedës telefonike është pajtuar me të gjitha gjetjet duke potencuar që i ka ngritur këto çështje me kohë mirëpo nuk e ka dëgjuar askush. Ndërkaq kur pyetjet i janë drejtuar me e-mail i njëjti ka arsyetuar çështjen e rrethojave për shkak të kushteve klimatike duke potencuar se do të zëvendësohen sipas paramasës, ndërsa për objektin e përkohshëm montues dhe tabelat sinjalizuese ka deklaruar se janë kthyer në vend punishte, përkatësisht zëvendësuar sipas paramasës. Lidhur me dritaret, i njëjti deklaroi se janë vendosur nga materiali plastikë për shkak të qëndrueshmërisë, mirëpo kur kemi kërkuar ndonjë dokument i cili dëshmon pajtimin e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik për një ndryshim ashtu siç kërkohet me Ligj, menaxheri ka deklaruar që nuk ekziston një dokument të tillë.¹⁰

Sa i përket qytetarëve, në përgjithësi vërehet se ata nuk janë edhe aq të kënaqur me këtë projekt dhe se nuk janë këshilluar nga komuna për ndërtimin e tij. Madje, katër nga gjashtë qytetarët e intervistuar mendojnë që Komuna e Junikut nuk ka pasur nevojë për një projekt të tillë sepse ka mjaft projekte të ngjashme. Qytetarët po ashtu kanë vlerësuar se çmimi i kontratës është i paarsyeshëm, kurse prioritetet që ka Juniku sipas tyre lidhen kryesisht me infrastrukturë rrugore. Gjithashtu, dy (2) nga gjashtë (6) qytetarët e intervistuar kanë apeluar që ky projekt të funksionalizohet dhe të mos mbetet si shumë projekte të pashfrytëzueshme.

¹⁰ Për më shumë shih neni 61.22- 61.26 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>

6.9. Komuna e Hanit të Elezit

Planifikimi i prokurimit

Komuna e Hanit të Elezit për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 63 aktivitete, 28 prej të cilave për punë, 13 për furnizime dhe 22 për shërbime. Kjo komunë e ka dërguar planifikimin e prokurimit në AQP më 27 mars 2020, pra brenda afatit ligjor.

Planifikimi i prokurimit të Komunës së Prishtinës ka përmbushur kriteret e formularit B01 sa i përket kontratave për punë dhe shërbime, derisa pjesërisht ka përmbushur kriteret sa i përket kontratave për furnizime.

Sa i përket zbatueshmërisë së planit të prokurimit, IKD dhe INPO gjejnë se Komuna e Hanit të Elezit nga pesë (5) aktivitetet e monitoruara, vetëm dy (2) nga to figurojnë në Plan të prokurimit, ndërsa tri (3) tjera janë zhvilluar pa qenë fare të planifikuara. Gjithashtu, Komuna e Hanit të Elezit, edhe pse në aspekt formal i ka plotësuar planet e prokurimit, pas analizimit të pesë (5) aktiviteteve vërehet se në Plan të prokurimit kanë përdorur tek njësia matëse shabllonin “kont”, ndërsa tek sasia “1,00”, të cilat fare nuk përputhen me njësitë dhe sasi të gjatë fazës tenderuese. Dy aktivitetet e inicuar të cilat mund të identifikohen në Plan të prokurimit, nuk kanë gjithashtu vlerë të njëjtë të parashikuar, gjë që dëshmon se Komuna e Hanit të Elezit nuk ka arritur që t’i qëndrojë prapa planifikimit që vetë ka hartuar sa i përket aktiviteteve për furnizim.

Sa i përket Komunës së Hanit të Elezit, IKD dhe INPO gjejnë se kjo komunë për aktivitetet për punë nuk e ka hartuar planifikimin e prokurimit në bazë të kapaciteteve të saj buxhetore. Diferenca në mes vlerës së parashikuar në plan dhe asaj në buxhetin për vitin 2021 është 22,000€.

Lidhur me aktivitetet për punë, IKD dhe INPO gjejnë se nga 28 aktivitete, aktiviteti “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave”, nuk identifikohet në buxhet, ndërsa sa i përket aktiviteteve për punë me kohëzgjatje 1-3 vjet, IKD dhe INPO- gjejnë se në këtë komunë janë zhvilluar vetëm dy (2) aktivitete. Të dy këto aktivitete janë të parapara në KAB të komunës, mirëpo vlerat e parapara nuk janë aspak të përafërta.

Sa i përket mënyrës së vlerësimit të tregut, Komuna e Hanit të Elezit ka deklaruar se kjo bëhet përmes daljes në teren.

Procesi i prokurimit

Lidhur me procesin e prokurimit, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) aktivitete për monitorim:

Aktiviteti	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
------------	--------------------	---------------------------------

1	Furnizim me kombi per hemodialize - Ritenderim 2	659-19-8887-1-2-1	25,000
2	Ndertimi i mureve mbrojtëse	659-20-3347-5-2-1	34,800

Sa i përket procesit të prokurimit, aktiviteti “Ndërtimi i mureve mbrojtëse”, ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit por me vlerë më të vogël, përderisa aktiviteti tjetër “Furnizim me kombi per hemodialize - Ritenderim 2”, nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit të komunës së Hanit të Elezit. Ndërsa, për të dy këto aktivitete, kjo komunë ka përgatitur deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, derisa anëtarët e komisioneve vlerësuese në asnjë nga këto dy (2) aktivitete nuk kanë pasur kualifikimet e nevojshme. Në asnjë nga aktivitetet e komunës së Hanit të Elezit nuk ka pasur as kërkesë për sqarime nga ana e operatorit ekonomik dhe as korrigjime nga autoriteti kontraktues.

Për sa i përket aktivitetit “Furnizim me kombi per hemodialize - Ritenderim 2”, ka pasur vetëm një ofertues. Ndërsa, tek aktiviteti tjetër, nga tre (3) operatorë ekonomikë ofertues, asnjë nuk është shpallur i papërgjegjshëm. Në këtë drejtim, në asnjë nga këto aktivitete nuk ka pasur as kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorëve ekonomikë, e as ankesa të paraqitura në OSHP.

Lidhur me sigurinë e tenderit, për aktivitetin e parë, kjo nuk është kërkuar. Ndërsa për aktivitetin “Ndërtimi i mureve mbrojtëse”, siguria e tenderit ka qenë valide sa i përket afatit kohor që është kërkuar, si dhe në përputhje me vlerën e kërkuar në dosje të tenderit.

Menaxhimi i kontratave

Sa i përket menaxhimit të kontratave, IKD dhe INPO kanë përzgjedhur dy (2) kontrata për monitorim:

Titulli: Pajisja e kabineteve me mjete mësimore dhe laboratorike	Titulli: Renovimi i QKMF-se Hani i Elezit
Numri i prokurimit: 659-19-5073-1-2-1	Numri i prokurimit: 659-20-3823-5-2-1
Vlera e Kontratës: 22,317.40€	Vlera e kontratës: 19,994.20€

Lidhur me menaxhimin e kontratave, Komuna e Hanit të Elezit në të dy (2) kontratat ka emëruar menaxherë të cilët i plotësojnë kualifikimet e kërkuara.

Kontrata për të cilën është zhvilluar vizita në terren në Komunën e Hanit të Elezit është kontrata me titull “Renovimi i QKMF-së në Han të Elezit”. Gjatë vizitës në terren është konstatuar se janë përfunduar punimet e përcaktuara sipas situacioneve siç janë: punët e

ngjyrosjes, punët e muratimit, punët e dyerve dhe dritareve, punët e WC, punët e ventilimit, ndriçimit, punët e bufesë, punët e dhomës së rëntgenit dhe punimet tjera që janë përfshirë: ulëset në korridor, monitori, tabela e informimit, dhe gjithçka ishte në funksion për të ofruar shërbimet për qytetarë.¹¹

Megjithatë, në korridor të QKMF-së kanë qenë të vendosura dhjetë (10) ulëse, ndërsa sipas paramasës, pozicioni I.10.1, ka qenë e paraparë që aty të vendosen vetëm gjashtë (6) ulëse. Komuna për secilën ulëse ka paguar 145€ për copë, ndërsa me këtë ndryshim në paramasë i bie që Komuna e Hanit të Elezit ka paguar 580€ më shumë për ulëset shtesë. I pyetur për këtë çështje Menaxheri i Kontratës ka deklaruar se “ky pozicion është shtuar për shkak të kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe se ky ndryshim është brenda vlerës së kontratës”, gjithashtu, vërehet se edhe kulmi i bufesë, pozicioni I.8.9. nuk është realizuar sipas paramasës, ndërsa sipas Menaxherit kjo ka qenë e panevojshme. Të gjitha këto gjetje dëshmojnë një keq planifikim nga Komuna e Hanit të Elezit. Sa i përket qytetarëve, gjejmë se të njëjtit janë të kënaqur me këtë projekt dhe se ky projekt ka qenë prioritet për ta. Sidoqoftë, përveç një (1) qytetari që është deklaruar se është këshilluar për këtë projekt, vërejmë se qytetarët tjerë nuk kanë qenë të informuar dhe vetëm gjyma e të intervistuarve e dinin koston e kontratës dhe kohëzgjatjen e saj.

¹¹ Për më shumë shih, kontratën dhe paramasën, e-prokurimi, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1097837.

7. Konkluzione

Procesi i buxhetimit

1. Konsultimi me shkrim dhe ai elektronik, si një nga standardet minimale të procesit të konsultimit publik me rastin e hartimit të Draft-Buxhetit është pothuajse formë e pazbatuar e konsultimit. Përkundër faktit se ky lloj i konsultimit paraqitet si obligativ, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, i njëjti është aplikuar vetëm nga Komuna e Vushtrrisë, si formë e vetme e konsultimit publik me rastin e hartimit të Draft-Buxhetit Komunal. Ndërsa, me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, asnjë prej komunave nuk ka zhvilluar këtë formë obligative të konsultimit publik.
2. Procesi i konsultimeve publike përmes publikimit të njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare të komunës përkatëse dhe në platformën e konsultimeve publike vazhdon po ashtu të mbetet sfiduese për komunat.
3. Sa i përket dëgjimeve buxhetore gjatë hartimit të propozim-buxhetit nga ekzekutivi i komunës përkatëse, nga nëntë (9) komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO, pesë (5) prej tyre kanë mbajtur dëgjime buxhetore, derisa katër (4) komuna të tjera nuk e kanë zhvilluar këtë formë të konsultimeve publike me rastin e hartimit të buxhetit komunal. Ndërsa, sa i përket takimeve publike me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se katër (4) nga nëntë (9) komunat e monitoruara kanë mbajtur nga një (1) takim publik, derisa këtë nuk e kanë bërë pesë (5) komunat e tjera.
4. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe përfaqësimi gjinor në komuna, përbëjnë sfidën kryesore për gjithë përfshirjen e dëgjimeve buxhetore.
5. Numri i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në buxhetin komunal ka qenë i ulët, madje nga nëntë (9) komunat e monitoruara, është evidentuar një (1) komunë, e cila nuk ka përfshirë asnjë kërkesë të qytetarëve në buxhetin e saj komunal.

Planifikimi i prokurimit

1. Asnjëra nga komunat e monitoruara, planifikimin e prokurimit nuk e ka hartuar në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.
2. Komunat nuk e përdorin Formularin B01 të aprovuar nga KRPP për planifikim të prokurimit, si pasojë e dështimit të KRPP-së që të njëjtin ta adaptojë në platformën elektronike e-prokurimi.
3. Nga nëntë (9) komunat e monitoruara, asnjëra komunë nuk e ka plotësuar planin e prokurimit në bazë të kërkesave ligjore, përkatësisht të dhënat për aktivitetet e furnizimeve nuk janë të plota dhe të sakta.
4. Komuna e Gjilanit, Hanit i Elezit, Junikut, Rahovecit dhe Vushtrrisë, kanë inicuar aktivitete për furnizim jashtë Planit të prokurimit.
5. Nga komunat e monitoruara, vetëm Komuna e Deçanit asnjërin nga aktivitetet e inicuar për punë me kohëzgjatje 1-3 vite nuk e ka të parashikuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022.

6. Nga intervistat e zhvilluara, rezulton se asnjëra nga komunat nuk bënë një analizë të mirëfilltë të tregut gjatë planifikimit, përkatësisht caktimit të vlerës së parashikuar të aktiviteteve.
7. Komunat gjatë analizimit të tregut fokusohen ose në dalje në terren ose në prokurimet e kaluara pa i analizuar të dyja bashkë apo edhe shtuar ndonjë mënyrë tjetër të vlerësimit, gjë që vërehet nga ndryshimi i vlerave të parashikuara gjatë inicimit të aktiviteteve.

Procesi i prokurimit

1. Shtatë (7) prej komunave të monitoruara (Prishtina, Peja, Vushtrria, Gjiçani, Deçani, Juniku dhe Hani i Elezit), njërin nga dy aktivitetet e monitoruara, nuk e kanë paraparë në Plan të prokurimit për vitin respektiv.
2. Pesë (5) prej nëntë (9) komunave të monitoruara (Gjakova, Peja, Rahoveci, Juniku dhe Hani i Elezit), njërin nga dy aktivitetet e monitoruara i kanë përfshirë në planin e tyre të prokurimit për vitin përkatës duke paraparë vlerë më të ulët krahasuar me vlerën e parashikuar në fazën e inicimit të aktivitetit.
3. Në tri raste, nga dy komuna të ndryshme (Junik dhe Hani i Elezit), janë identifikuar komisione të vlerësimit të ofertave, anëtarë të të cilëve nuk kanë pasur kualifikimin e duhur.
4. Nga 18 aktivitetet e monitoruara, njëra komunë (Prishtina) për njërin aktivitet nuk e ka zbatuar procedurën e duhur, përkatësisht ka zbatuar procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë duke e minuar konkurrencën.
5. Autoritetet kontraktuese, komuna e Vushtrrisë, Prishtinës, Hani të Elezit dhe Deçanit kanë shkurtuar afatet për pranimin e tenderëve në kundërshtim me dispozitat e nenit 46 të LPP-së. Në një rast (Junik) nuk kemi pasur të bëjmë me shkurtim të afateve ligjore, mirëpo njoftimi për kontratë është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, për shkak se ky Autoritet Kontraktues nuk ka përcaktuar afatin minimal prej 20 ditësh për dorëzimin e ofertave, por ky afat ka përfshirë periudhën kohore prej vetëm 17 ditësh edhe pse nuk ka pasur shkurtim të afateve.

Menaxhimi i kontratave

1. Komuna e Deçanit tek kontrata “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit”, nuk ka arritur që të ekzekutojë pagesat tek Operatori Ekonomik në përputhje me kushtet e kontratës dhe nivelin e shërbimeve të kryera.
2. Komuna e Junikut tek kontrata “Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes”, ka pranuar siguri të ekzekutimit për periudhë kohore më të shkurtër sesa minimumi i lejuar me ligj.
3. Komuna e Prishtinës tek kontrata “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, nuk ka kërkuar zgjatjen e validitetit të sigurimit të ekzekutimit të kontratës, respektivisht siguria e ekzekutimit nuk ka pasur validitet së paku 30 ditë pas përfundimit të kontratës.

4. Komuna e Deçanit në bazë të intensitetit të pagesave të kontratës “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit”, nuk do të ketë mirëmbajtje për tridhjetegjastë (36) muaj sepse limitet e kontratës do të arrihen shumë më shpejtë dhe për pasojë të keqplanifikimit do të detyrohet që të inicojë procedurë të re.
5. Komuna e Gjilanit nuk ka arritur ende ta përfundojë kontratën “Ndërtimi i tregut të gjelbër”, edhe pse e njëjta është dashur të përfundojë në vitin 2018.

8. Rekomandime

Procesi i buxhetimit

1. Nëntë (9) komunat e monitoruara të zbatojnë obligimin e mbajtjes së konsultimit me shkrim dhe elektronik me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore. Po ashtu, këto komuna të zbatojnë obligimin për publikimin e Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore, njoftimit për konsultim publik, afatin dhe adresën zyrtare për dërgimin e komenteve në faqen zyrtare të komunave dhe platformën e konsultimeve publike.
2. Ekzekutivi i Komunës së Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Rahovecit, Deçanit, Junikut dhe Hanit të Elezit të zhvillojnë procesin e konsultimit publik me shkrim dhe elektronik në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna me rastin e hartimit të buxhetit komunal për vitin pasues. Në drejtim të zbatimit të këtij obligimi, komunat duhet të publikojnë 1) projekt-propozimin, 2) adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet, 3) informata mbi personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe 4) afatin për dorëzimin e komenteve. Me këtë rast, komunat krahas faqes së tyre zyrtare, këto informata t'i publikojnë edhe në platformën e konsultimeve publike. Afati i konsultimit publik si në këtë mënyrë të jetë të paktën 15 ditë pune, i cili afat duhet të përfundojë më së largu deri më 15 gusht të vitit përkatës, në mënyrë që nga kjo datë e deri më 1 shtator të vitit përkatës, ekzekutivi i komunës përkatëse të ketë mundësi t'i shqyrtojë këto kërkesa buxhetore.
3. Në secilin rast, ekzekutivi i komunave të organizojë dëgjime buxhetore. Përkundër faktit se me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna përcaktohet obligimi i ekzekutivit të komunave që të mbajë të paktën një (1) dëgjim publik, IKD dhe INPO rekomandojnë që paraprakisht, komunat të hartojnë një plan të dëgjimeve buxhetore, në mënyrë që këto dëgjime të përfshijnë sa më shumë qytetarë dhe të ketë shtrirje në të gjitha fshatrat, lagjet, vendbanimet dhe zonat urbane. Ky plan të përshtatet varësisht specifikave të një (1) komune të caktuar dhe të synojë gjithëpërfshirje të qytetarëve në procesin e buxhetimit, duke marrë përsipër lehtësimet maksimale për qytetarë, për pjesëmarrjen e të njëjtëve në këto dëgjime buxhetore.
4. Komunat inkurajohen të aplikojnë edhe format e tjera të konsultimit publik, jo obligative sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Planifikimi i prokurimit

1. Komunitetët të hartojnë planin e prokurimit në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe Formularin B01. KRPP të sigurohet që formulari B01 të adaptohet në platformën elektronike e-prokurimi, në mënyrë që komunitetët planifikimin ta kenë në përputhje me këtë formular.
2. Komunitetët të sigurohen që planet e prokurimit t'i përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme, përkatësisht tek aktivitetet për furnizim, sasi dhe njësi të jenë të sakta, ndërsa komunitetët që fare nuk i kanë të vendosura këto të dhëna, të kujdesen që në të ardhmen të njëjtat t'i vendosin konform kërkesave ligjore. Komuniteti i Gjilanit, Hani i Elezit, Junikut, Rahovecit dhe Vushtrrisë të sigurohen që aktivitetet e inicuar për furnizim të jenë të planifikuara me plan të prokurimit.
3. Komunitetët të sigurohen që planifikimet që i bëjnë të kenë mbulueshmëri në buxhet, përkatësisht kosto e aktiviteteve të planifikuara për punë të jetë e njëjta edhe në buxhet, respektivisht të mos jetë më e lartë si në komunitetët: Deçan, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Junik, Pejë, Prishtinë dhe Rahovec, ose më e ulët si në Komunitetin e Vushtrrisë.
4. Komunitetët të bëjnë një analizë të mirëfilltë të tregut duke marr parasysh të gjitha elementet e rëndësishme në mënyrë që planifikimi i vlerës së kontratës të jetë sa më i saktë me vlerën reale.
5. Komunitetët gjatë analizimit të tregut të mos fokusohen vetëm tek dalja në terren ose kontratat e mëparshme, mirëpo t'i konsiderojë gjithmonë që të dyja dhe gjithashtu të shikojë manualët për çmime referente të publikuara nga KRPP dhe çdo mundësi tjetër që sjellë rezultate të një planifikimi real.

Procesi i prokurimit

1. AK-të t'i përmbahen me përpikëri Planit të Prokurimit, të cilin e përgatisin me qëllim të realizimit të duhur të buxhetit.
2. AK-të të caktojnë anëtarë të komisioneve për vlerësimin e ofertave persona me kualifikim të duhur, përkatësisht kualifikimi i tyre të jetë në përputhje me natyrën e aktivitetit që prokurohet.
3. AK-të të zbatojnë procedurat e duhura me rastin e inicimit të procedurave, përkatësisht mos të përdorin pa arsye procedurat të cilat e minojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë.
4. Autoritetet Kontraktuese të sigurohen që Operatorët Ekonomikë të ofrojnë siguri të tenderit sipas vlerës së kërkuar me dosje të tenderit, përkatësisht të mos nënshkruajnë kontratë nëse nuk janë plotësuar në mënyrë strikte të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Menaxhimi i kontratave

1. Komuniteti i Deçanit të sigurohet që për kontratat e nënshkruara të ekzekutojë pagesat në bazë të kushteve të kontratës dhe nivelin e punëve të kryera.
2. Komuniteti i Junikut të kujdeset që siguria e ekzekutimit të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, përkatësisht në bazë të afateve minimale të parapara me ligj.

3. Komuna e Prishtinës të kujdeset që siguria e ekzekutimit të jetë në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe kur kjo kërkohet me dosje të mos nënshkruajë kontratë pa ekzistimin e një sigurie të ekzekutimit valide.
4. Komuna e Gjilanit të sigurohet që kontrata të përfundojë brenda afateve të caktuara, përkatësisht në përputhje me kushtet e veçanta të kontratës.